Fadil Curri

“HANI I TRE DJAJVE”

(Prozë letrare)

Editor
Azam Dauti

Recensent
Rexhep Bajrami

Fadil Curri

"HANI I TRE DJAJVE"

(Prozë letrare)

Botues
Shkupi
Shkup, 2O24

UDHËKRYQI

Ai kishte nisur të ecë, por nuk e dinte për ku. I ngjante një ecjeje alesë së shtruar me hare e trishtim, me dashuri e urrejtje, me besim e zhgënjim, me dërdëllisje e memeci, me shikim e verbëri, me urti e marrëzi, por para së gjithash i dukej se ecte drejt së panjohurës që do të pjellë zhgënjim apokaliptik. Ecja e tij vërtet i dukej tërë labirinte, tërë hamendje e dy mendje, pyetje me kah-e e si-he, pse-he e sa-he, por kurrë pas tyre nuk shihte sepse-he, ngase-he, meqë-he. Shpesh e shau veten pse ishte mësimdhënës i dobët i gjuhës e të mos mund të krijojë fillim e mbarim një fjali të përbërë me pjesë të nënrenditura qëllimore, shkakore e kushtore, ngase kur arrinte ta vazhdonte pjesën e dytë, që gramatikisht i thonë e varur ose e nënrenditur e që rendomë është pas presjes, diçka e stepte, e mbërthente për gjymtyrë, sikur e zanonte, e shitonte ndonjë hije mali. Mitike e pashmitizuar i dukej gjendja e tij.

Ndjenjat, preokupimet, parafytyrimet, trazimet në unin e tij plogështar ishin të shumta dhe u ngjanin

rrebesheve të plumbave e që hidheshin në shtatin e tij. Kërkoi një strategji ushtarake ta tejkalojë shpëtimin nga to.

- Nga do t'ia mbash, o Idil?! - dëgjoi një zë pyetës me petk si të habisë deri sa arriti makina para një udhëkryqi, folësin e të cilit nuk e shihte. - Mbrapa nuk mund të kthehesh. Të kanë ngelur dy rrugë pa rrahur dhe patjetër të ecësh djathtas ose majtas.

- Do të shkoj te Idila ime, - iu përgjigj Idili befasueshëm, i përballur me trishtimin çmendurak, kur pa që nja dhjetë hapa para tij ishte një humnerë.

Zëri që e dëgjoi Idili sikur u zhbë dhe nuk u dëgjua për disa minuta, edhe kur ky i fundit dëgjoi pyetjen e djaloshit "Kush je ti?" Pas rreth një ore dëgjoi zërin e njëjtë, por disi më të shurdhër se i mëparshmi:

- Dëgjo, djalosh, unë jam Zëri i së Vërtetës. Kujdes, gjendesh në një zonë të rrezikshme, në një trekëndësh jetëngrënës për njerëz të dashuruar në atë që e duan Matanëmalin, njerëzit e tij, - u dëgjua Zëri i së Vërtetës, që Idilit iu duk se erdhi shpatit të malit përballë. – Ti ke të drejtë në qëllimin tënd, por do të përballesh në shumë pengesa, ndaj të duhet mençuri, guxim, durim e flijim.

Edhe pse nuk ishte ashtu, sikur Zëri i së Vërtetës thirri ca hije që po lëviznin me shpejtësi të madhe drejt

tij. Ishin nja dhjetë njerëz të pajisur me rroba e vegla lufte deri në dhëmbë. Në kokë mbanin helmeta me yll të kuq. Mbanin edhe armë më të përsosura të kohës. Flisnin një gjuhë që e kuptonte, por që nuk ishte e tij. Ia lidhën duart me pranga, ndërsa fytyra e trishtuar e djaloshit po lyhej me frikë e pritje çfarë do të ndodhë pastaj me të. Njëri nga rreth dhjetë veta, që dukej më hijerëndë dhe që dallohej nga veshja prej të tjerëve, e pyeti djaloshin:

-Cili je ti? - Dy ushtarë u larguan pak më anësh në krahët e djaloshit dhe i drejtuan tytat drejt tij, sigurisht për të mbrojtur kapon e tyre nga ndonjë e papritur. - Çfarë kërkon në këto anë?

- Unë jam idili, - iu përgjigj djaloshi dhe nisi të nxjerrë dokumentin e identifikimit, por e ndali trishtimi i bërtimës së dy ushtarëve që ia drejtuan me të shpejtë tytat e pushkëve.

- Mos lëviz! - e urdhëruan dy ushtarët e harbuar djaloshin.

Udhëheqësi i ushtarëve ua bëri me dorë dy vartësve të ndalonin, kurse vet bëri ecje gjysmërrethi dhe u largua nja dy-tre hapa nga djaloshi.

- Përgjigju në atë që të pyeta - e kujtoi udhëheqësi i ushtarëve.

Djaloshi sikur u qetësua nga frika e përjetuar pak më parë.

- Kam dalur ta kërkoj të dashurën time,- u përgjigj djaloshi disi më i lehtësuar.

- Të dashurën?! E, kur të ka humbur? Si quhet dhe si duket ajo? Nga ç'vend është?

- Po, e kërkoj të dashurën time që e dua shumë. As vet nuk e di kur më ka humbur, por e ndjej se më ka humbur. E dashura ime quhet Idila dhe duket bardhane, si shpirti i saj, e dashur dhe e urtë si e Bukura e Dheut. Më kanë thënë se e kësaj ane është, saktësisht nuk e di nga ç' fshat ose ç' qytet.

Prijësi i thirri ushtarët e tij dhe nisën të ecnin ngadalë nëpër gjethet e rëna të dushqeve vjeshtake. Biseduan se ky djalosh qenka interesant me këtë që po flet. U morën vesh se njëri që fliste gjuhën e djaloshit, ta merrte në pyetje dhe ta përkthente bisedën, gjoja për të lehtësuar rrëfimin e djaloshit. E udhëzuan ushtarin që fliste gjuhën e djaloshit për pyetjet që do të shtroheshin dhe si do të pyeste. Përsëri kthyen aty ku ishin.

- Djalosh, kur e ke parë për herë të fundit të dashurën tënde? Cilat kanë qenë fjalët e fundit që të ka thënë para se të ikte? Nga ç'anë të tha se po shkonte?

Djaloshi në këto çaste të vetmen ngrohtësi e kishte hënën e plotë që i rrinte mbi kokë. Ndjeu sikur edhe ta vrisnin, hëna do të rrëfejë si ka vdekur dhe se ky rrëfim do të depërtojë edhe te veshët kureshtarë të Idilës së dashur.

- E dua hënën, - foli djaloshi.

Udhëheqësi, kur dëgjoi këtë përshtypje të tillë, i erdhi të qeshë qetë me të. "Sikur e pyetëm në e do hënën ose jo", ndjeu një nervozë në vete.

- Përgjigju në atë që të pyeti udhëheqësi, - i tha ushtari që e fliste gjuhën e tij. – Mos bëj mahi me ne, sepse mund të gjesh më të keqen, sa edhe hënës t'i dhimbsesh.

Djaloshi sikur e mori inat këtë ushtar që fliste gjuhën e tij, më shumë se të tjerët.

- Unë nuk e di kur e kam parë të dashurën time për herë të fundit, mbase një natë, një vit, dhjetë, një mijë vjet, nuk e di sa. Fjalët e fundit, kur ma morën me dhunë Idilën time të dashur, kanë qenë: "Më kërko me mend, durim, dashuri të pashuar dhe puno në këtë drejtim tërë jetën. Bindu, po veprove kështu, do të më gjesh, do të më riduash në shtratin tënd. Më tha: "Po më marrin me dhunë dhe në të gjitha anët që të më kërkosh, mund edhe të më gjesh".

Kur ushtari që e dinte gjuhën e djaloshit ia përktheu udhëheqësit të tij fjalët, tundi kokën si habitshëm. Iu duk djaloshi si torollak, por fjalët ishin me shumë ogure.

- Pyete djaloshin, e di që është zonë kufitare në këtë anë, - e urdhëroi kapoja ushtarin që e dinte gjuhën e dashnorit të Idilës dhe ky i fundit e bëri.

- Nuk di ç' është kufiri. Nuk po kërkoj kufi, por të dashurën time, Idilën, të cilën ma rrëmbyen me dhunë dhe nuk ma kthyen më dot. As juve nuk ju kërkova, por ja që ju gjeta. Mbase e gjej edhe Idilën time së kërkuari. Më ka marrë malli për të, gati më janë qorruar sytë nga dashuria e madhe që kam për të.

- Kush ta rrëmbeu dhe kur? - e porositi udhëheqësi ushtarin që fliste gjuhën e djaloshit që ta pyesë atë.

- Nuk e di saktësisht kush ma rrëmbeu. Ishim në një hotel luksoz. Disa njerëz në një tavolinë vendosën të ma rrëmbejnë dhe e bënë. Isha i vetëm dhe i pafuqishëm ta mbroja Idilën time të dashur. Në atë kohë unë flija dhe, kur u zgjova nga trishtimi, e pashë se e morën me vete të dashurën time. Herën e fundit që e kam parë Idilën time të dashur, ka qenë në ëndërr. Më nuk e kam parë. Ajo është e dashura e ëndrrave të mia, ndaj e kërkoj me shkop e strajcë ta gjej, pikërisht natën, që të mos më

zë gjumi. Udhëheqësin e ushtarëve e mbuloi një shqetësim në fytyrën e tij, ndaj urdhëroi ta rrihnin djaloshin dhe ta hidhnin tatëpjetë përroit të grykëmalit. Dy ushtarët e tjerë dolën nga grupi dhe e goditën me grushta, shqelma, kondakë pushkësh dhe, si një ngordhësirë të vrarë, për krahë e këmbë e kapën dhe e hodhën tatëpjetë lisnajës djaloshin e përgjakur. Pas trupit të tij u dëgjuan krisma pushkësh. Djaloshi e humbi vetëdijen nga goditjet e shumta nëpër trup, sidomos në kokë, ndaj nuk dinte çfarë kishin biseduar ushtarët duke e shikuar si rrokullisej tatëpjetë lisnajës.

HËNA 24

Nata e kishte mbërthyer gati në të gjitha anët gazetarin F., sa edhe mendimet i dukeshin të atilla, pra të mbërthyera. Qielli ishte i errët, por nuk donte ta krahasonte me natën, sepse, ndryshe nga ajo, qielli ishte më i vrazhdët. Kishte dalur në ballkon dhe shihte të vetmen dritë, hënën. Sikur ia drejtonte rrugëtimin e shpirtit. Gati ishte bërë e rrumbullakët. Për habi të tij, në këtë tis të zi përzier me të kaltër, të rrallë ishin edhe yjet. Nuk pa më tepër se një ose dy yje. U ngjanin dy të dashurve që rrinin krahëkëmbëve të njeriut në agoni dhe që nuk i dihet sa do te zgjasë çasti që të japë frymën e fundit të shpirtit. Nuk donte të vdiste hëna kurrsesi, sepse me të e lidhte një ndjenjë e re dhe e vjetër.

- O yje, kujdesuni të mos vdesë hëna. Atë e dua shumë, sepse është dëshmitare në një dashurie të madhe times, - sa nuk bërtiti nga ballkoni e të trishtonte fqinjët në gjumin e thellë.

– Mos edhe ju fqinjët e mi gjumashë po shihni ëndërr hënën e yjet? Por, nuk shihni e nuk përjetoni si unë, edhe të përjetësuar hënën në zhgjëndërr.

E shikoi edhe pak dhe shpejt u fut brenda katit të parregulluar si duhet, brenda të cilit mori dy tulla dhe vuri para tij, mbi to një dërrasë të gjerë, e cila i kishte mbetur si material i tepruar kur e kishte ndërtuar shtëpinë para tre vjetësh. Zbriti shkallëve tatëpjetë dhe mori një fletore, stilolaps dhe telefonin. U kthye edhe një herë dhe e mori fotoaparatin. Të gjitha këto i la në dërrasën që i shërbente si tavolinë shkrimi. Ndezi cigaren, si e kishte shprehi kur ia niste të shkruante, ndonëse shpesh i digjej dhe nuk e thithe fare tymin e saj.

Ra në dymendje: ta fotografonte hënën ose të niste të shkruante. Të bënte punën e parë, kishte frikë mos i iknin idetë; t'ia niste të shkruante, kishte frikë mos i ikte hëna. Së pari e fotografoi hënën dhe dy yjet, me arsyetim vetes - edhe nëse ikin idetë, fotografia do t'ia kujtonte ato që kishte pasur ndërmend të shkruante. Fundja, fotografimi i hënës ishte punë e vogël, mjaftonte vetëm një, dy ose tre "shkrap-e" që të fotografonte hënën dhe mund të shkruante tërë natën e ditën e nesërme. Kurse, po të shkruante, nuk dinte sa do të zgjaste të shkruarit e pjellës së rradakes së tij dhe hëna do t'ia tregonte bërrylin duke i thënë: "Mos mendon, zotrote, se natën do t' a zgjasë Zoti për hirë tëndin dhe të të rri unë para syve si nuse e paluar. Edhe yjet, edhe një yjësi e tërë

nuk mund të më mbajnë më, sepse sovrani i ditës, zotëri Dielli, vjen e më shporr si lëvozhgë limoni. Ikaaaaaaaaa", sikur dëgjoi zërin e hënës, që herë iu duk mahi kërcënuese që të shkruante me shpejtësi, herë zgërdhirje ngacmuese për gazetarin F... që duhet të shfrytëzojë atë që ka përpara sa nuk i është tretur hap e mbyll sytë. Ndaj, mori lapsin dhe nisi të shkruajë në fletore, herë-herë duke ia hedhur një shikim të shkurtër hënës dhe dy yjeve.

"Ishte natë e ngjashme si para 24 vjetësh, e vjeshtës së tretë. Kisha shkuar me shokë të rrinim disa ditë te një mik i studimeve, i cili jetonte në një fshat kufitar me vendin amë. Në televizorin e shtëpisë së shokut më ra në sy një pamje qyteti parafestiv. Një gocë, studente e historisë, para kamerës fliste për madhështinë e së shkuarës së kombit të saj, pra edhe të timit. Goca fiste gjuhë të pastër dhe me sintaksë të rrjedhshme. Ishte andej nga jugu. Edhe unë që e studioja gjuhën e letërsinë, por në një universitet të ndarë me kufi të egër, u dashurova në atë vajzë të bukur dhe me gjuhë të ëmbël. Nga frika mos më hetonin të familjes së shokut mikpritës, bile edhe vet shokët e studimeve, kërkova të dal në çardak të shtëpisë dhe të ndez një cigare në freski. Dolëm me mikun e studimeve, në shtëpinë e të cilit kisha ardhur mysafir. Pashë që hëna ishte rrumbullake, e plotë. Nisa ta shikoja me sy të picërruar atë dhe yjësinë rreth saj. E pashë orën që ishte 24, pra mesi i natës, ose si i

thonim në familje me gjysmën e saj, 12, kur shoku më përmendi, duke më thënë se isha zhytur duke e soditur hënën, mbase do të shkruaja ndonjë poezi për të. Kisha nisur edhe t'i numëroja yjet. Plot 24 arrita, pra ishin shtuar, e po të mos më kishte shkundur nga përhumbja shoku i studimeve, kushedi sa do të arrinin. Mbase edhe kaq kishin qenë.

"Hëna i ngjan njeriut femër", iu shpreha shokut im, por nuk rrëshqita të shpjegoj atë çfarë ndjeja.

"Nise të filozofosh poetikisht? E, pse mendon se i ngjan njeriut femër hëna?", më pyeti goxha kureshtar shoku i studimeve.

"Nuk e sheh se brenda rrethit të saj ka si dy sy, hundë e buzë? Nuk e sheh se yjet u ngjajnë çamarokëve të një nëne, pra të hënës? Nuk e kupton edhe fjalën "hënë", sikur ka kuptimin "hë, nënë" që i kërkon fëmija nënës diçka, ose që hëna, pra nëna, i jep yjeve me fjalët "hë, na" me domethënien "merre". Ajo flet me dy dialektet: Hana për "ha(na)në" në veri dhe hëna për "hë(në)në" për jug".

"Hajt, ore, hymë brenda se u ftohëm duke e shikuar "hë(në)nën" e "ha(na)nën". Po të rrinim më gjatë, do të dalë dielli e do të më flasësh edhe për të si për hënën", më luti shoku i studimeve që ishte në shtëpinë e tij.

“Hëna e ka burrë diellin dhe mezi e pret të vijë ai”, i thashë dhe ktheva të hymë brenda në dhomë, pasi ia dhashë edhe një shikim hënës dhe yjeve, sikur përshëndetesha me ta dhe falënderohesha pas një bisede te gjatë.

Shoku më shikoi habitshëm, disi si me frikë, si kur pyet njeriu tjetrin “je tamam me mend?”

HANI I TRE DJAJVE

Kreu i parë: SHITA

1

Ende pa u gjetur të vrarët e të zhdukurit nga lufta që mbërtheu vendin, ende pa u shpërndarë kundërmimi i erës frymëzënëse nga trupat e djegur e të kalbur, ende pa u kthyer nëpër shtëpitë e tyre njerëzit e përzënë dhunshëm, liria ende ishte në ag dhe popullit i ishin sytë me ag përpara, nisën të duken oguret e llojllojshme, të venerohen njerëzit që i kishin hipur pelës mbrapshtë, si thoshte një frazë popullore për ata që kishin marrë tatëpjetën e që nuk donin të kthenin në mbarësi. Për habi, duartrokitjet hipjes së pelës mbrapsht buçisnin dhe zëri i shuplakave dëgjohej larg me orë ecjeje më këmbë dhe lart deri në kodrat, që mbase as këmba e armikut nuk kishte shkelur atje.

Më parë se të gjallët e të vdekurit të ktheheshin nëpër shtëpitë e tyre, më shpejt se ata, kishin ardhur legjendat e gojëdhënat për njerëzit e ngjarjet e kësaj ane dhe ishin ulur këmbëkryq në ballë të odës. Me rëndësi është që bisedat të bëheshin për to, sepse ka shpresë që diçka më e mirë se kjo gjendje mund të bëhej më vonë. Zaten, edhe rrethanat i kishin më të përshtatshme gojëdhënat në fillim të këtij kthimi, sepse nuk kishin rrymë dhe nuk mund të shiheshin objektet e gjallesat qartë, ndaj paqartësia e tyre ndihmonte që përjetimet të bëheshin gojëdhëna vrikthi; nuk kishin mjete të marrëveshjes, sa biseda shpejt bëhej përfolje e përgojim i shtrembëruar; nuk kishin kushte të jetës normale në fillim, sa jeta e vdekja kishin një lezet. Vendi ngjante në një nga ata që i kishin dëgjuar në përrallat e babait të tyre sa ishin fëmijë, veçmas ajo për zanën që i kishte gurëzuar tre vëllezërit, pasi i kishte përçarë, duke i premtuar secilit se atë do ta marrë për burrë. Si në përrallën e babait, edhe këta tre bashkudhëtarët ishin vëllezër që ktheheshin nga lufta, ku kishin shkuar të vrisnin Ujkun e Kuq.

Bënte errësirë e lemeritshme, sikur edhe hëna kishte frikë të dukej në qiell. Atje, diku shpatit përballë, u duk një farfurimë drite e një figure njeriu. Vëllai i madh thoshte se ishte në serm burri dritërima, i ndërmjetmi thoshte në atë të femrës, kurse i treti donte t'i bindte dy vëllezërit se gjysma e trupit ishte femër e gjysma

mashkull, bile herë pjesën e epërme të trupit e bënte mashkull e gjysmën e poshtme e bënte femër e herë gjysmëtrupat e kundërta gjinorisht. Vëllait të vogël iu kujtuan fjalët e gjyshes, e cila na qortonte të mos dilnim jashtë natën. Sipas saj, terri është shumë i keq, se erërat e liga të vetmuarit i sulmojnë dhe i tjetërsojnë dhe, pastaj e rrëfente përrallën e zanimit të tre vëllezërve. U kishte rrëfyer se ngjarje të çuditshme e njerëz të çuditshëm përhiren sidomos nëpër luftëra, fatkeqësi natyrore, ditënetëve, javëve e muajve të mëdha, ngase erërat e liga, djajtë e shtrigat lëshohen në hajni e vjedhje, shkaktojnë llahtari të shumta, bëjnë luftë me engjëjt e njerëzmirët, rrëfente gjyshja, duke porositur që gjatë këtyre rrethanave të ecin së paku vet i dyti ditën, kurse së paku vet i treti natën, ose të mos ecnin fare. Te Laku i Territ, ku përroi në kohë të liga me gurgullimë më të trishtueshëm e bën vendin, disa hapa larg tyre e panë një hije të bardhë. Ishte grua e bukur, sipas fjalëve të saj, kishte emrin Shit ose Shitë, nuk e kuptuan dot si tha.

"Nëse je mashkull, duhet të quhesh Shit, e nëse je femër, duhet të quhesh Shitë", disi e shprehu zemërimin ndaj saj vëllai i vogël, kur iu kujtua se një zanë quhej Shitë, pra Shita, e cila i shitonte, i gurëzonte njerëzit, i stepte dhe i njerizonte përsëri ata. Edhe në përrallën e gjyshes e të babait e kishte emrin Shitë-Shita zana.

Takuan zanën e keqe ose Shitën, që e e quanin në këto anë.

Ndonëse e kishin fituar luftën kundër Ujkut të Kuq, zana që kishte shkathtësitë e Dhelprës Shituese, ende pa shkuar në shtëpi të kumtojnë fitoren, ua preu rrugën si hije dhe veç e veç i mashtroi dhe i shitoi tre vëllezërit. Duket se ajo ishte përgatitur ose dikush e kishte mësuar të takohej me tre vëllezërit e hareshëm se po ua sillnin në shtëpi e lagje lirinë e ëndërruar. Në sytë e fjalët e vëllezërve Shita kishte lexuar lodhjen buzë këputjes së trupit, se ata ishin të uritur e të etur jo vetëm për bukë e ujë, por për shumëçka. Bindjen se ishin të lodhur, Shita ua shprehu gjoja me keqardhje vëllezërve, të cilët nuk folën shumë nga këputja, por e tumirën vetëm më tundje koke e lëvizje duarsh.

"Doni të ju sjell diçka të hani e të pini?" i pyeti vëllezërit me gjoja keqardhje dhe dëshirë për t'u ndihmuar.

"Kemi nevojë, ç' ke më, por si mund të na ndihmosh, oj e uruar?" pyeti vëllai më i madh.

"Ja, pak më tej, në përrua, e kam mullirin dhe mund të jua sjell ca bukë e një shtambë me ujë", u premtoi. "Mund të vijë ndonjëri nga ju e të më ndihmojë".

"Ja, do të vijë ky më i vogli, se ne jemi të lodhur më shumë gjatë luftës me Ujkun e Kuq, e ai është më i ri

dhe më shumë mund të të ndihmojë", iu përgjigj vëllai i ndërmjetmë.

Vëllai i vogël e Shita u nisën për te mulliri, si tha ajo. Në kthesën e parë, në të majtë të rrugës, një frymë e papritur i shkundi kurmet e dy udhëtarëve. Nga qafa e saj u këput stolia e formës rreth i artë, varur saj edhe një strajcëz me metelikë margaritari. Këtë e vërejtën dy vëllezërit, por nuk i bënë zë Shitës. Pasi u shafit pluhuri i erës së madhe, dy vëllezërit shkuan te vendi ku kishte nisur era dhe iu vërsulën qafores e strajcëzës së metelikëve të margaritartë. Nisi një grindje ndërmjet tyre, sa nuk u shkonte mendja të shihnin a dukej diku vëllai i tretë dhe Shita në bashkudhëtim.

"Qaforja dhe qesja me metelikë margaritari më takojnë mua", u shpreh vëllai më i madh.

"Nëse ty të takuakan, së paku një pjesë e tyre të më japësh mua, sepse jam i pamartuar dhe më duhen për dasëm. Bile edhe Shitën dua ta marr për nuse, sapo të kthehet dhe nuk është e ndershme të mos shpërblehet ajo me diçka të florinjtë", rrëfeu qëllimin e tij vëllai i ndërmjetmë.

"Jo, edhe Shitën nuse për mua e marr, sepse jam më i madhi dhe nuk e di se a e kam gruan gjallë ose jo. Do të shkojmë radhazi, dasmat e pasuritë i bëjmë me rend, nga më i madhi deri te i vogli".

"Vëlla, ty nuk të takojnë nusja, paratë e florinjtë, të tërat. Edhe unë duhet të kem diçka, edhe më i vogli vëlla yni duhet të ketë. Lipset të merremi vesh, së paku ne që e çliruam vendin nga Ujku i Kuq, që të mos na shpotit bota se paskëshim luftuar sall për veten, e jo edhe për vëllazërinë e popullin. Nëse nisim e ndajmë kështu trofetë e luftës, ka rrezik të mos na mbetet asgjë. Ndaj, kujdes vëlla".

Ecnin dhiarit të rrëpinjtë, shpat lart e greminë poshtë. U nxehën fjalët ndërmjet vëllezërve, me to edhe vet vëllezërit As ata nuk ditën se si përnjëherë u kacafytën, pa e parë se mund të rrokulliseshin tatëpjetës në përrua, siç u ndodhi. Trupat e tyre goditnin rrënjë e lisa, ferra e gurë, u përgjakën dhe u dobësuan, u molisën me humbje vetëdijeje. Dy vëllezërit përfunduan tatëpjetës te mulliri i Shitës. Kur erdhën më vete, në livadhin afër mullirit u panë me Shitën e vëllain e vogël. Këtu panë edhe shumë të njohur, njerëz që kishin luftuar bashkë kundër Ujkut të Kuq. Shita nuk ishte më me ato veshje të bukura e të shtrenjta. Në qafë mbante rrethin e artë e qesen me margaritarë, për të cilin u grindën dy vëllezërit e mëdhenj.

(Tregim i papërfunduar,

sepse shkrimtari ndërroi jetë)

KTHIMI MBRAPA

DHE PSIKIATRI PSIKOPAT

Njerëzit ende nuk ishin shëruar si duhet as pas 15 vjetësh nga krimi masiv i diktatorit që mëtonte ta bëjë rajonin si donte vet, por që përfundoi duke i humbur edhe ata që i kishte pasur nën hije. Ende shihnin ëndrra se si vriteshin njerëzit para syve, si vajzën e re e zhvishnin para prindërve dhe e futnin në ndonjë skutë dhe që nga andej prindërit dëgjonin klithmën e saj të përdhunimit dhe që nuk mund ta shpëtonin, nuk mund t'i ndihmonin dot. Dhjetëra mijëra njerëz e gjetën vdekjen nga mendja gjakpirëse e diktatorit, i humbën duar, këmbë, sy e vesh, i cili gjakësor trumbetonte se ai që nuk është me ne, është kundër nesh, pra kundër tij. Kështu kishte vepruar edhe paraardhësi i tij, i cili i kishte vënë kusht një populli; ose do të pranosh kodikun tim për heqje dorë nga rrënja jote e të kalosh në degën time, ose do të të shkojë koka.

Pas luftës shumë njerëz kishin kërkuar ndihmë nga një psikolog, por meqë rrënimet shpirtërore e mendore ishin të mëdha, i kishte dërguar t'u ndihmojë

psikiatri. Trajtim pas trajtimi që kishin pasur te ai hallexhinjtë, u bindën se ai kishte qenë psikiatri më psikopat, i cili dashka t'ua imponojë njerëzve vetëm mendjen e vet. Bile, kishte joshur që ajka intelektuale të vendoset nga laboratori hulumtues e zbulues në pavijonin e të sëmurëve psikikë. Këtë e kishte dëgjuar shkrimtari dhe, si njeri që i studion personazhet, pra edhe psikiatrin psikopat, e vuri në sitën letrare profilin e tij. Nga letërkëmbimet e personazheve doli se psikiatri qenka ithtar i kthimit të historisë mbrapa, se aty e gjente shërimin e çdo sëmundjeje. Bile, me këtë mendje kishte pas shkaktuar murtajën e prishjes së fytyrës së lagjes, të shumicës së banuesve të saj. Personazhet e kishin biseduar se ku do te vendoseshin si popull, në cilën periudhë historike; në regjimin komunist, para 100, 200, 500, 1000 ose 2000 vjetësh. Tjetri tha se kthyer se kthyer, do të kthehemi në rrënjët tona, kur nga një det në tjetrin det ishim Zot vet. Kur u zu në gojë i vetmi i Lumi Zot, psikiatri psikopat sikur u tund kokë e këmbë, sa një fytyrë i vinte e një tjetër i shkonte, sepse nuk e donte kthimin në rrënjët e vërteta, por në gjysmëtrung, aty ku donte vetëm vet, pra në degë, mbase të tharë. Kthimi i pjesshëm ngjalli mosbesim te populli, bile se e kishte kurdisur armiku i përbetuar.

"Duket se ky heretik do të këmbejë një Zot për një zotëri", shprehu dyshimin Bardhylli i lagjes veriore.

“Huq do t’i shkojë kjo përpjekje psikiatrit psikopat. Ka pasur edhe të tjerë si ky, ka edhe sot”, shprehu bindjen Pirro i lagjes jugore. “Nuk kemi nge ta mohojmë veten, historinë, bëmat tona. Në vend të ecim bythëprapë, duhet të shpejtojmë ballëhapur përpara.

Dikush tjetër tha se këtë psikiatër psikopat e paskan dërguar ata të Hanit të Tre Djajve. Njëri si në mahi ironizoi, duke thënë se më mirë është të kthehemi në majmunë. Me mendimin e Bardhyllit e të Pirros, ithtarëve të tyre, edhe shpotitësit, nuk u pajtua kurrsesi psikiatri psikopat, sepse e donte vetëm teorinë e vet. Nuk arritën marrëveshje, sepse në secilën periudhë të shkuar që të vendosej ky popull, do të nxirreshin telashe me veten dhe me fqinjët e shumtë; do të nxirreshin armiqësi të reja edhe nëse vendoseshin në periudhën e preferuar nga psikiatri psikopat, meqë ithtarët e tij nuk do të hiqnin dorë nga atdheu i ri, sepse lëndohej sedra e miqve edhe të psikiatrit psikopat.

Pleqëruan sa pleqëruan personazhet dhe vendosën që kthimi nga e shkuara është mohim i vetes, vrasje e një pjese biografie, aventurë sipas parimit 'hiq një kashtë e dalin gjashtë' ngjashëm me "duke i hequr pa mend vetullat, i hoqi edhe sytë". Asnjëri nga ata nuk e donte errësirën e së djeshmes, por dritën e së sotmes për të shikuar të nesërmen. Kot psikiatri psikopat teorinë e tij dëshironte ta shpjegonte si hyjnore, kur bindjet e popullit që të mos kthehen mbrapa kishin dëshmi aksiome. Qenë

të mendimit të mos kthehen në të shkuarën, të mos na kthehen të sëmurët shpirtërorë e mendorë, që ajka e intelektuale të mos shkojë në pavijonin e psikiatrisë, sepse ka rrezik që këta të bëheshin si banuesit e pavijonit, të dalë mendsh e të përdalë shpirti.

"Ne edhe kur shahemi, e bëjmë në gjuhën tonë; edhe kur lutemi e pajtohemi nëpër faltore, e bëjmë me gjuhën tonë, edhe kur bëjmë besëlidhje, e bëjmë në gjuhën tonë. Biografinë tonë nuk e sakatosim, por e zgjasim me dashuri e punë, tok si dy sy të një balli të shikojmë përpara, të shkojmë atje ku është e shkon e gjithë bota e mirë. Edhe nëse u themi të tjerëve se nuk jemi këta e se duam të bëhemi si duan ata, përsëri nuk na besojnë, sepse na njohin më mirë se pandehim, ata na duan si livadh e për këtë edhe mundohet psikiatri psikopat. Mjaft na ndëshkuan të tjerët me tragjedi traumatizuese, mjaft na bënë copë e grimë deri sot, ndaj nuk kemi nge të copëtohemi ende. Gjuhën, tokën, historinë, flamurin i kemi dorëzanë të të gjitha kohëve. Partitë politike, krahinore, besimore e shpirtërore, bajraqet, le t'i mbajë secili në bindjen e vet, në familjen e vet, por vijën e kuqe të gjuhës, kombit, historisë, tokës, nuk bën të na e përdhosë askush, për më pak ne. Zoti na ndihmoftë në këtë rrugë!", u dëgjua njëri personazh me zë kumtues në emër të një pajtimi të të gjithëve.

INTERVISTA ME PERSONAZHET

Ata kishin ardhur dhe rrinin shpresueshëm përreth shtëpisë së shkrimtarit, si të ishin bletë rreth zgjoit të tyre, që lule më lule e kishin vjelë nektarin dhe dronin që dikush mund t'ua prishte ose t'ua vidhte. Nxori fotoaparatin dhe i shëmbëlleu fytyrat e tyre, pastaj edhe i futi të gjithë në kompjuter nxitimthi, sikur dronte mos po i iknin njerëzit para shtëpisë. Ishin gra me e pa shami, pleq me e pa qeleshe, të rinjtë me e pa xhinse, disa të kapur për dore me dashnorët e dashnoret e tyre, ndonjë më guximtar putheshin ndërmjet vete. Picëroi sytë në kompjuter dhe curroi veshët për të shikuar fytyrat, veshjet e mbathjet e llojllojshme, për të dëgjuar britmat e tyre që herë u ngjanin çjerrjeve me fytyra, herë këngëve, herë vajeve, brohoritjeve, sharjeve, herë lutjeve e më shumë nga të gjitha, ankesave e zhgënjimeve.

»Heeeeeeeej, mjaft më me fjalë të thata, me do ta bëjmë pa e bërë kurrë, me prit sot e mos bëj nesër«, e dëgjoi një klithmë nga kompjuteri i njeriut rreth të dyzetave, i cili dukej se ishte me kukëza në duar, njeri i

sakatosur rëndë. »Më morët gjithçka që pata, më ka mbetur vetëm një gysmëkëmbë dhe ky shpirt, hë mos qoftë edhe ky, që të përjetoj mynxyrat që edhe hasmit mos ia pafsha në jetë«.

»Oj vdekje, sillja jetës së pështirë më të dashurin e humbur, kënaqe me pakënaqësinë e palakmuar as për Xhebrailin e tij të kësaj jetës«, dëgjoi një grua të rreth pesëdhjetave. »Ma kthe rehatinë e gjumit për varrin e merituar si njeri, sepse nuk jemi racë e kafshëve endacake të ngordhura përrenjve ujëtërbuar të dimrave vrastarë e fushave zharritëse të pranverave buzëthara. Kush ma vodhi zogun me cicërimën e tij mëngjesore? Kthemani ngushëllimin shpëtues për të palindurit, së paku! Mos ma sillni ujkun në torishtë, heeeeeeeeejjj!«

»Puthja na i ngjan dashurisë fantome, buzëqeshjes optiiiiiikeee të shpiirtit sahariaaaaaaaan«, dridhte dhëmbët me dhëmballat fuqidhënëse djaloshi përqafshëm me bukuroshen, që vazhdimisht intonacioni i zërit i ngritej nga zeroja derisa arriti në kulm të jehonës, sikur kumtonte mbi male e fusha, lumenj e dete. »Mos iu falni krimbit të kolltukut kundër bekimit të Madhështisë Engjëllore«

Shkrimtari u step nga pamjet e fytyrave të njerëzve të turmës, sikur ato ishin të paparashikueshme, që edhe kur dukeshin më të lumtura, kishin strukur në to shtatzënitë që do të plasnin shpejt. Herë këto fytyra i

dukeshin të buta, herë kriminele, ndonjëherë që kumbonin si topat zhbirues mishngrënëse, herë si bombat-lubi barngrënëse. Edhe kur gabonin, kishin arsye, sepse gabimet në fjalë i bënin nga zemrat e thyera, sepse kërkonin ata që ia kishin marrë pa i pyetur, pa exhel, si i thonin kësaj ane. Ai gati u llahtaris kur dëgjoi një fjali të gjymtuar dhe mezi të kuptuar: »Shkrimtar, së paku ti na i shpëto vdekjet përballë të palindurve, te të gjithë i kemi humbur shpresat; së paku ti na mbaj në krah, nuk kemi kujt tjetër t' i besojmë«. I thoshte këtij ose ndonjë tjetri, nuk e kuptoi dot shkrimtari, por e kuptoi se ai që e tha, ishte një plak rreth të tetëdhjetave, i cili disi pëshpëriti se shkrimtarit i besonte kur shkruante, sepse veprimi i shkrimit për të ishte kontakt me Zotin, me dritat e mëshirës hyjnore.

Do të kridhej edhe më shumë, mbase edhe veten do ta harronte shkrimtari, sikur celulari mos dridhej, pastaj edhe të lëshonte zërin e tij përmendës. Ishte gazetarja e televizionit, grua e një miku anas, e cila kërkonte intervistën të të nesërmen drejtpërdrejt, gjatë së cilës ishte tema e librit, brenda së cilës edhe roli i shkrimtarit ndaj njeriut, profili i tij në jetë. Ishte në dymendje, të vazhdonte intervistën me të vdekurit e virtualizuar në kompjuter, që herë-herë i dukeshin se vërtet turma e njerëzve ishte para shtëpisë së tij, ose të përgatitej për intervistën e nesërme. Një mendje i thoshte

ta shtyente intervistën televizive, por para një jave i kishte premtuar dhe do të dilte mashtrues mediatik.

Vendosi të shtrihej për gjumë dhe e bëri këtë. Ashtu i shtrirë, tërhoqi një batanie dhe e mbuloi trupin e rraskapitur, sikur e mbuloi edhe mendjen e shpirtin e sfilitur nga intervista me njerëzit klithës. Iu duk vetja se e kishte zënë gjumi për një çerek ore, kur u zgjua rrëmbimthi. Kishte parë ëndërr fytyrë njeriu, që nuk e kuptonte ishte femër ose mashkull, i ose e gjallë apo i ose e vdekur. Vetëm rrinte e nuk fliste asgjë, kërkonte mëshirë me shikimin e saj. Pamja e fantazmës në ëndërr iu duk si e pikturuar ose e balsamosur, si e gjallë-e vdekur, sikur i përfaqësonte të trazuarit e para një ore. E shikoja në ëndërr dhe frikësohesha ta pyesja, ta puthja, ta ledhatoja, ta përshëndetja me dorë ose fjalë. Sikur më tjetërsoi ajo pamje dhe unë u bëra si ajo, bile më poshtëroi kur mori guximin të fliste: »Unë jam ata, të cilët i përgjoje e vështroje pak më parë, jam uni i tyre, kipci. Më dërguan të të rrëfej se shpëtimin e kemi te ti dhe vetëm në ty: si shkrimtar që je, të na i amshosh ëndrrat bekueshëm«.

Në studion e televizionit ishin brengosur se shkrimtari nuk do të ishte i pranishëm në emisionin e paralajmëruar, vaj-halli që pastaj të humbin besimin te shikuesit e tyre. Meqë ishte edukuar në jetë i përpiktë, ndonëse shpesh në biseda e pohonte arsyetimin» me kësmet po, sepse vetëm Zoti rri në një karar«, u ul në

kanapenë e studios si gjysmënjeri e gjysmëhije. »Jam unë ose hija ime, së paku jam vetja«, e ngushëlloi veten me qëllim trimërimi. I pyeti kameramanët dhe skenaristët, gazetaren e kujdesshme për ambientimin e mysafirëve në studio se në dukej mirë. »Çdo gjë është në rregull, po shkëlqeni, mik i nderuar«, i dha krah gazetarja që ishte në moshe me fëmijët e tij. Pas një shikimi vendimtar studios, sidomos kamerës dhe kanapesë ku ishte ulur pranë mysafirit-shkrimtar, ajo qortueshëm dha kumtin »Shkojmë« dhe pas disa sekondash iu drejtua mysafirit: »I nderuar shkrimtar, si duket profili i krijuesit«?

Pyetje e papandehur, por meqë kishte përvojë krijuese në letërsi dhe me intervista në media, një frymë sikur i dha energji intelektit të tij. »Kur punoja gazetar, kam pasur bindjen se ky profesion nuk ka orar të caktuar të punës. Ka ndodhur që sapo kam shkuar në shtëpi, ndonjë ngjarje e ndodhur më detyronte të kthehesha në redaksi dhe të hartoja lajmin për botimin më të hershëm, bile edhe në orët e vona të natës më ka ndodhur, sapo kam rënë të fle«. Gazetarja sikur u lehtësua nga kjo pjesë e përgjigjes, duke e pyetur se ku dallon gazetaria nga shkrimtaria. »Shkrimtari dallon nga gazetari, sepse i pari lëre që nuk ka orar të punës, por edhe në gjumë krijon, gjen zgjidhje për personazhet e ngjarjet, porositë e shkrimit. Mbrëmë më ka ndodhur që të nis shkruarjen e një prozë, por nga lodhja më zuri gjumi. Në ëndërr e vazhdova shkrimin, bile e përfundova papandehur. Pra,

shkrimtari është me ngjarjet e personazhet e vet edhe kur fle, edhe kur sheh ëndërr, por edhe pas vdekjes së tij«.

Të gjithë të studios ishin çmeritur me minutën e tridhjetë të lëvizjes së akrepit të orës, me kohën e pavërejtshme të ikur. »Ne ende nuk ia kemi nisur intervistës«, shprehu kënaqësinë gazetarja, ma bëri me dije se shumëçka kanë mbetur pa u ditur. Pasi larg kamerave shkrimtari u rrëfeu për tregimin e nisur në zhgjëndërr dhe të vazhduar e mbaruar në ëndërr, atyre të studios iu duk vetja e ngjashme me personazhet e prozës së shkrimtarit.

UNË JAM UNI ME HIJEN TIME

Dikush dëshiron të më konsiderojë jashtëtokësor e jashtëkohësor i këtij nënqielli, sepse nuk do të më ndjejë afër tij, nuk do të më shohë si fqnj i krahpërkrahshëm; nuk do njëkohësisht me të të jemi në ulëset e bibliotekës, të bankës, të kadastrit, në aeroport, parlamentit; nuk do të më shohë në sallën e tribunës e të tryezës me të, nuk do të më shohë në ngjarjen simfonike me të dhe as në orën letrare, në ngastrat e gërmimeve arkeologjike. Kur duan të më shohin si numra statistikorë demografikë, më ndjejnë si popull me atdhe alienësh e fantazmogjenikë; kur duan të më këpusin gjëllimin e zinxhirit të ndërkohësisë historike, më thërrasin me certifikatën e lindjes të ardhacakut të ngulur dhunshëm skaj tij. Kur duan të fshehin llavën e shkaktuar nga ta, më bëjnë krater-fajtor i përhershëm që shuan krahina e perandori të paemra në hartat e pastajme.

Sidoqoftë, prore jam me hijen time në këtë vend dhe me biografinë time në nëpërërkohësi.

QYTETET E VENDET SHQIPTARE

TË MAQEDONISË NË POEZINË

E JOSIF BAGERIT

Josif Bageri i Rekës së Epërme, Nistrovës së vendlindjes së tij, i ngjan një intelektuali të anatemuar ose të inkuzicionuar, një rilindësi real që rilindi shumë me vonesë. Duke i lexuar poezitë e tij, më ranë në sy poezitë e dedikuara disa vendeve ose qyteteve shqiptare në Maqedoni, si janë Shkupi, Dibra, Manastiri, Reka, elementi hidrogjegrafik, pasaj qytetet që janë shqiptare jashtë Maqedonisë, por që ndërlidhen me fatin e përbashkët shqiptar (Elbasani) dhe qytete e vende joshqiptare, por që përsëri ndërlidhen me veprimtarinë shqiptare (Sofja e Bullgarisë). Poashtu vendet që përmenden në këto poezi janë Shqipëria, Bullgaria, Greqia (herë si More), Serbia, Turqia e Maqedonia.

Në poezinë "Shqyptarët e Shkupit" poeti Josif Bageri duket se ka dije për këtë qytet, popullatën e tij gjatë historisë dhe të aktualitetit, ngaqë si "kjytet i dëgjuet", ka vërejtuar shumë sprova, por që kohët e fundit, pra për aktualitetin bagerian, ka nisur një rrugë të mbarë. Kjo intuitë e Bagerit është në përputhje me të dhënat historike dhe me kronikat e shtypit të atëbotshëm të dekadës së parë të shekullit XX në prak të Pavarësisë së Shqipërisë dhe njohjes ndërkombëtare si shtet. Sipas të dhënave që sjell gazeta "Shkupi" e Jashar Erebarës, me të cilin kishte kontakte edhe Josif Bageri, Shkupi në kohën kur u shkrua kjo poezi ishte qendër e lëvizjeve kombëtaare shqiptare, ku kishte klub, gazetë dhe pretendohej së shpejti të hapej edhe shkolla shqipe. Përpjekjet unifikuese shqiptare jepnin fryte të mëdha, sipas poetit, duke lënë zënkat, të cilat i quan "të zonat" dhe kjo sillte deri te vellazërimi, duke i bërë nder atdheut, "amës", si e quan Bageri.

Josif Bageri në këtë poezi nëntekstualisht Shkupin e identifikon si pjesë të Gegënisë e Kosovës, me trima të ngjashëm që i kishte edhe pjesa tjetër e Shqiptarisë, Toskëria, ose Toskinia, si e quan poeti. Nyje e përbashët e trimave gegë e toskë është gjuha, për të cilën kanë dhënë edhe besën se do ta mësojnë dhe se nuk duan të ngelin në errësirë. Përparimi që ndjehet ndër shqiptarët e Shkupit në vargjet e tij sheshon ekzaltimin për kohën e mirë që ka arritur, duke e shpëtuar Shypninë, si e

emërtron, nga përmbytja e saj. Poeti Josif Bageri poezinë e përfundon me dëshirën-bekim:

T' rrojn Shkupnjonët dhe Shqypnia!
T' rrojn klubi me gjith shok!
T' rrojn bashkimi e vllaznia!
Kështu du për Qill' dhe tok.

Josif Bageri poezi i kushtom edhe krahinës shqiptare me besim ortodoks, Rekës, në fshatin Nistrovë të së cilës edhe u lind në vititn 1870. Se është i mishëruar në këtë krahinë, dëshmojnë edhe dy pseudonimet, me të cilat nënshkruhej në krijimet letrare, Rek Rekasi dhe Shpirti i Rekës. Shkroi edhe poezinë "Reka vendi im", në të cilën, ngjashëm si në atë që ia kushton Shkupit, Rekën e konsideron si pjesë të Shqipërisë. Për Rekën shkruan:

Përveç shqypen tjetër s' di,
Se kërthinëz je n' Shqypni.

Në këtë poezi Rekën e prezenton si me njerëz të ditur e mjekë të arritur. E quan edhe zemra e Shqypnis e vend i trimnis. Jep porosi Rekës të mos jetë si ka qenë, por të gjejë ndonjë trim që do të udheheq. Nga vargjet e poezisë"Lamtumirë" mësojmë se Reka ishte detyrë dhe

dëshirë që të vdesë Josif Bageri në të, jo në shtrat, por në luftë për liri.

Në poezinë "Dibër" Josif Bageri bën përshkrimin bukolik të kësaj ane, sigurisht më qëllim shpirtëzimi atdhetar te lexuesi. Këtu është ideja për krijimin e një ushtrie me flamurin e kuq në dorë, duke nisur nga një udhëhqeqës më "kumandarë" të tjerë.

Poezi tjetër që ka temë qytet shqiptar në Maqedoni është "Kushtrimi i shqyptarvet në Monastir". Edhe ky qytet në periudhën e Parapavarësisë ishte tejet me rëndësi për çështjen shqiptare, posaçërisht që krijoi veprën historike të njësimit të alfabetit të gjuhës shqipe dhe evitoi ndasitë që shkaktonin përçarje ndër shkruesit e letrave shqipe. Poeti mbase duket panegjerik kur shkruan se Natyra i ka krijuar shqiptarët me ndjesi të mirë, kur senitësit e të gjitha anëve shqiptare arrijnë e tubohen në Monastir këtë muaj (nënkuptohet se poezia është shkruar në nëntor 1908) që të kuvendojnë për gjuhën shqipe.

Siguria e Josif Bagerit për rëndësinë e përcaktimit alfabetik shqiptar është vizionare, sepse do te krijojë lulëzimin kombëtar. Autori, ngjashëm si te poezia për Shkupin e shqiptarët e tij, edhe këtë poezi me temë Manastirin e përfundon me dëshirën-bekimin

T' rrojn! Këta trima, senitës kombi
Se ky kushtrim ton botën trondi!...

Të rrojn Shqypnija me gjith bijt e sajë!
Besa tosk e gegë, kurrë nuk dajë.

Josif Bageri si frymëzim qytetin e Monastirit, si e quan Manastirin, e letrariozon edhe në poezinë "Nji piramid dëshmorvet". Shtjellon fatin elegjiak pas vrasjes së tre atdhetarëve shqiptarë nga grekët, një tregtari e dy priftërinjve. Priftërinjtë Kristo e Vasil, si dhe tregtari Spiro Kosturi, ndonëse u vranë nga andartët grekë, poeti ka bindjen se nuk ua kanë vrarë shpirtin e dëshmorëve dhe idetë e therorëve. Këta kishin predikuar fenë në gjuhën shqipe. Prift Vasili ishte dergjur dhe kishte vdekur në burgun e Manastirit.

Nëpër poezitë e Josif Bagerit lexojmë edhe për qytetet tjera shqiptare dhe joshqiptare, si është Elbasani i pasnormales, kur poeti porosit që të shkollohen edhe shqiptarët e këtushëm. Shkruan poezi edhe për shoqërinë shqiptare në Sofje të Bullgarisë, ku vepronin shumë shqiptarë, ndër ta edhe Josif Bageri. Kur jemi këtu, është interesant se nga të gjithë fqinjtë, Josif Bageri veçon për harmoni me shqiptarët popullin bullgar, ashtu si nuk pandeh për turqit e serbët (sllavët), kurse grekëve u jep qortim se nuk kanë pjesë në Maqedoni.

POSHTËSHËNIM:

Më 25 qershor 2011 në lokalet e Universitetit Shtetëror të Tetovës u mbajt simpoziumi kushtuar jetës e veprës së Josif Bagerit. Në punimet e këtij simpoziumi u lexuan rreth 30 kumtesa. Ndër to ishte edhe kumtesa ime "Qytetet e vendet shqiptare të Maqedonisë në poezinë e Josif Bagerit". Ky punim është më i gjatë, por meqë kriteret e simpoziumit ishin tetë minuta, u desh të reduktohej qasja. Pas leximit të teksteve, në ciklin e debateve e diskutimeve autori i këtij vështrimi sheshoi propozimin që në tekstet shkollore shqipe jo vetëm në Maqëdoni, në faqet e tyre të gjenin vend edhe poezitë, letrat ose ndonjë krijim me rëndësi e me vlerë e Josof Bagerit. Ky propozim hasi në përkrahje, bile edhe duke e plotësuar me ndonjë shkrimtar të anatemuar, si ishte Sadudin Gjura. Josif Bageri lindi në një krahinë shqiptare me besim ortodoks, e cila krahinë në masë të konsiderueshme është sllavizuar nga pushtetet mbretërore jugosllave, asaj titoiste të RSFJ e kësaj etatiste të Republikës së Maqedonisë.

EH, SHKRIMTAR I HARRUAR,

RAMADAN ZEJNELI

(1952-1993)

Eh, shkrimtar i pandalur, mësues e mik i dashur, Ramadan Zejneli! Kur më shkoi mendja për ty, ndjeva trishtim më së shumti për një arsye: si të harruan kaq vrazhdët?

Për të rinjtë që nuk e kanë njohur këtë njeri, dua t' ua bëj me dije se ka qenë mësues i fshatit Lypeten të Shkupit, shkrimtar i mbi dhjetë librave letrarë, autor i shumë shkrimeve gazetare dhe satirist i vyer sidomos pas demokracisë demagogjike në Maqedoni. Familja e Ramadanit ishte me prejardhje nga Burimi (ish-Zeqishta) i Hanit të Elezit.

Pas vdekjes së tij nuk e kujton as edhe ndonjë shoqatë ose klub shkrimtarësh e arsimtarësh në Shkup e Maqedoni me ndonjë orë letrare e përkujtim, as ndonjë redaksi me shkrim për letërsinë e krijuar të tij, as ndonjë

emision RTV, as me ndonjë konkurs letrar që mban emrin e tij ose ndonjë shpërblim, as ndonjë institut, teatër, shkollë, as i (ri)botohet ndonjë libër nga botuesit e shumtë me të sotëm, me të cilët ka bashkëpunuar sa ishte gjallë. Askush nuk e kujton shkrimtarin Ramadan Zejneli!

Nuk të kujton kush nga viti 1993, kur ndërrove jetë, sepse ti nuk i bëje temena pushtetit, sepse ti ia çjerrje maskën shtetit që i shpërfillte bashkëkombetarët tuaj, sepse nuk ishe as në qarqet e mafisë letrare të përkëdhelur nga shteti që edhe sot i shpërblen e mirënjeh njerëzit e atëbotshëm, që ua mjaltos buzët edhe sot si mirënjohje që ata bënë dikur dhe që e bëjnë mbase edhe sot për të, me të cilat nderime e peshqeshe shteti i Maqedonisë ua shpërlan euforikisht biografitë e zeza para popullit të vet.

Eh, Ramadan Zejneli, e dimë që shteti ty nuk të shpërblen si disa shkrimtarë shqiptarë puthadorë të tij, por së paku ndonjë organizëm letrar shqiptar, kulturor, arsimor së paku të të kishte kujtuar me diçka, së paku të të kishte mirënjohur për punën që ke bërë. Nuk e bënë këta që trumbetojnë se duan ta zhvillojnë kulturën shqiptare, nuk e bëjnë këta "fijues, patriotë letrarë" të saj, nuk e bëjnë se nuk e duan shkrimtarin e mirëfilltë, sepse dje kështu i ka mësuar "nëna-parti" dhe sot i mëson njerka-»demokraci« me "letërsi shqiptare".

Ramadan Zejneli ishte i martuar dhe pas vetes nuk la fëmijë, por la gruan ende gjallë që jeton me kujtimin dinjitoz për burrin e saj, falë dhuntisë letrare nga Zoti dhe puna e përkushtimtë, la pas vetes libra shumë të dashur letrarë që lexoheshin e lexohen me ëndje, sidomos në rrethet e shkollarëve, përmes të cilëve e forcoi kujtimin e nderimin tim për të, pavdekësinë letrare të tij. Ai shumë i dha letërsisë shqiptare, sidomos në Maqedoni, e ajo nuk është në gjendje të bëjë as edhe një punë të vogël ta nderojë dinjitetin njerëzor dhe letrar të tij.

Eh të gjorët ne që jemi humbur pas ëndrrave mashtruese të jetës së pacipë dhe nuk i kujtojmë të merituarit letrarë.

Më fal që nuk po kam mundësi të bëj më shumë për ty, o Ramadan Zejneli, por e di se ti je shembull se si të mirët harrohen në kohën qorre, sepse popullit nga një mal pa moral që e ka para, nuk sheh dhe nuk mund ta kalojë atë! Turpi nuk ka brirë dhe gjuhë të rrëfejë, por ai përjetohet.

Ah, Ramadan Zejneli, më bëre vrer dhe e kam vështirë të besoj se edhe shkrimtarët nuk e duan shkrimtarin!

Pushofsh në parajsë me mëshirën dhe shpërblimet e Zotit!

"TI SHKRUAJ PËR LIBRIN TIM,

UNË SHKRUAJ PËR TËNDIN"

Duket se edhe shkrimtarët po i ndjekin gjurmët korruptive të politikanëve sipas stilit përfitues "ti mua-unë ty". Këto ditë më ra në sy një shëmti letrare, kur dy shkrimtarë shkruajnë për librat e njëri-tjetrit brenda një muaji.

Në kohën e sotme të mundësive kibernetike të shpërndarjes së teksteve e shkrimeve, nuk është lehtë që një shkrimtar nga jugu, veriu, lindja e perëndimi shqiptar, bile edhe nga mërgata më e largët të komunikojë me kolegun e tij të penës, t'ia dërgojë dorëshkrimin ose librin PDF tjetrit dhe, ky i fundit për hirë të së mirës që ia ka bërë miku duke shkruar për librin e tij, ia kthen të mirën me të mirë, pra shkruan edhe ky për librin e të parit shkrimtar.

Reciprocitetit përmes kritikës letrare, recensioniste më shpesh, që duket se po gëlon, nuk ka qenë vështirë t'i shihen oguret, nëse e përcjell "letërkëmbimin" letrar ndërmjet autorëve në sheshimet e

tyre në FB (fejsbuk, faqelibër). Nëpër komentet e tyre shihen lëvdatat për njëri-tjetrin, edhe kur duhet shprehur lapsin për shpotitjen e ligësive stilistike, gjuhësore, fabulative teorike.

Të gjitha këto dikush mund t'i pandehte si liri fejsbukiane e jovëmendje e çastit para se të marrë formën serioze. Por, të arrihet në shkallë të matrapazllëkut sipas ëndjes reciproke "ti shkruaj për librin tim, unë do të shkruaj për librin tënd", qoftë edhe me panegjerizëm të pamerituar, thjesht i thonë tregti e palejueshme e llojit letrar.

Shëmti tjetër analogjike e kësaj natyre është që hasim në festivalet kulturore-letrare. Juritë gjatë organizimeve, edhe ashtu të rralla, janë sa për sy e faqe, sepse gati paraprakisht është e ditur se cili mik i ndonjë zyrtari organizativ do të marrë shpërblimin, meqë më parë ose ka shkruar për ndonjë libër të tij, ose ia ka dhënë ndonjë shpërblim në njërën nga katër anët shqiptare të letërsisë.

Së këndejmi, edhe këtu sipas parimit besnik të dyanësisë "ti mua ma jep shpërblimin te ti, unë ta jap shpërblimin te unë", qoftë edhe nëse vlera financiare e shpërblimit sigurohet nga buxheti i popullit varfanjak.

Ekonomistët këtë shpagim korruptiv letrar e quajnë kliring, pra mall për mall. Shkrimtarët e

kulturorët shpesh mbërthehen nga leverdia, sa edhe nuk e kuptojnë se bëjnë kundërthënie interesi dhe presin që zyrtarët e politikanët t'ua kujtojnë. Këta të fundit janë më të shkathtë dhe më syçelë në fushën e konfliktit të interesit, sepse kanë përvojë mafioze me tenderët e ndarjet e të mirave sipas praktikës "ti mua-unë ty", kurse shkrimtarët e gjorë vërehen lehtë dhe po aq lehtazi shkelin shpejt në "drras' të kalbtë".

ZHDUKEN GJURMËT

E SHQIPTARËVE TË KRISHTERË NË SHKUP

Përpara hyrjes në Qendrën Tregtare të Qytetit të Shkupit ka qenë shtëpia ku ka lindur bamirësja nobeliste shqiptare Gonxhe Bojaxhiu (alias Nënë Tereze). Këtë fakt e pata mësuar nga intervista me Dr. Gjergji për gazetën »Flaka« të Shkupit e »Sharri« të Hanit të Elezit, të cilën dëshmi e pata letrarizuar edhe në romanin tim »Kronikë për një dashuri«.

Elementi katolik shqiptar në kryeqytetin e Dardanisë dhe të Vilajetit të Kosovës, Shkup, ka qenë shumë i dendur dhe veprues para ardhjes së komunizmit në ish-Jugosllavi (Maqedoni).

Nga aspekti kontinuel shumëshekullor për komunitetin katolik shqiptar mësojmë nga veprat e Dr. Gaspër Gjinit, që nga përhapja e krishterizmit monoteist në Iliri deri në kohën moderne, sidomos kur bën fjalë për Ipeshkvinë Shkup-Prizren. Familja e G. Gjinit jetoi në

Shkup, ndonjë nga ata e kisha edhe moshatar shkolle. Me ndonjë nga miqtë e mi intelektualë me potencë institucionale pata ngacmuar nismën që ndonjë rrugë, institucion ose shkollë të mbajë emrin e Gaspër Gjinit. Këtu, pra në Shkup, kanë jetuar e vepruar shqiptarët katolikë, mjeshtër të penës e të dijes, kuptohet edhe misionarë shqiptarë, si Pjetër Bogdani, Pjetër Mazreku, Lazër Mjeda e të tjerë.

Gjatë fëmijërisë dhe rinisë time shkollore kisha mocanikë e mësimdhënës shqiptarë katolikë, të krishterë, kurse deceniet e fundit nuk duket prania e tyre në Shkup e gjetiu. Asimilueshëm veproi regjimi jugosllav në Maqedoni ndaj tyre, pas instalimit etatist, veproi ndaj shqiptarëve të cilitdo komunitet fetar qoftë. Kësisoj pati vepruar edhe ndaj komunitetit shqiptar ortodoks, duke e sllavizuar gati rrënjësisht, deri edhe në zhbërje gjuhësore të shqipes së tyre, të Josif Bagerit.

RËNDËSIA SHQIPTARE

E KONGRESIT TË MANASTIRIT

Rilindja Kombëtare Shqiptare dhe Lidhja Shqiptare e Prizreni paraqesin dy organizime panshqiptare me platforma, njëra kryesisht në drejtim kulturor civilizues, e tjetra në planin politiko-ushtarak. Lëvizjet gjoja liberalizuese në Perandorinë Osmane pas Tanzimatit, sidomos të Xhonturqve, sollën klimën që edhe shqiptarët të përkujdeseshin për fatin e tyre çlirimtar.

Fakti se kombi shqiptar ndahej administrativisht në katër vilajete, besimin e kishte në tre konfesione, dialektologjikisht e fliste gjuhën shqipe në gegërisht e toskërisht dhe e shkruante me së paku tre alfabete, krijonte sfida për mos standardizimin e tij drejt unifikimit shqiptar. Shqiptarët e Veriut, që e flisnin gegërishten, i përkisnin kryesisht besimit mysliman dhe katolik dhe në shkrimet e tyre shërbeheshin me alfabetin arab (myslimanët) dhe latin (katolikët). Shqiptarët e

Jugut, që kryesisht ishin myslimanë e ortodoksë, gjatë shkrimit te tyre shërbeheshin me alfabetin arab (myslimanët) dhe grek e herë-herë edhe sllav (ortodoksët).

Kjo ndarje alfabetike e shkrimit të shqiptarëve ishte edhe shkak për ndarjen në baza fetare e krahinore dhe sillte pengesa të mëdha. Apeli i Klubit te Manastirit "Bashkimi" për tubimin e filologëve, shkrimtarëve e dijetarëve shqiptarë në Manastir nga 14-22 nëntor bëri që të organizohet një si lloj parlamenti shqiptar jo vetëm për unifikimin alfabetik të tyre, por që ishte edhe me rëndësi mbarëshqiptare.

Në të morën pjesë shumë shkrimtarë të shquar shqiptarë, si Gjergj Fishta, Hilë Mosi, Mihal Grameno, Mit-hat Frashëri, Gligor Cilka, Ndre Mjeda, Emin Kumbara. Njerëzit organizues dhe pjesëmarrës të Kongresit të Manastirit ishin bartës të atdhetarisë dhe shkrimtarisë shqiptare të Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe të periudhës së Pavarësisë së Shqipërisë e më vonë.

Dhe, ky unitet shqiptar sikur i tronditi armiqtë e popullit shqiptar, qeverinë xhonturke që përmes mbrojtjes së alfabetit oriental, të ushtronte trysni me djegie shtëpish dhe vrasje të pishtarëve të arsimit e alfabetit shqiptar dhe kishën ortodokse greke, e cila ishte edhe si zëdhënëse e mbrojtjes së interesave sllave kundër shqiptarëve.

Manastiri i asaj kohe ishte qytet me rëndësi jo vetëm shqiptare, por edhe si qendër konsullore ndërkombëtare. Krah zhvillimit kulturor i dha edhe lëvizja ungjillore, që merrej me sensibilizimit alfabetik përmes botimeve.

Fisi i Qiriazëve, jo vetëm që mori flamurin prijatar për organizimin e Kongresit të Alfabetit, por më parë kishte bërë punë të madhe në shkollën e hapjes shqipe për femra në Korçë, themelimin e shtypshkronjës shqipe, klubin "Bashkimi" dhe veprimtari individuale letrare e atdhetare.

Në një poezi të mësueses Parashqevi Qiriazi, që në një farë mënyre është edhe si himn për alfabetin, theksohet se armiqtë e shqiptarëve duan shkronjat turke e greke të na japin dhe në fund jep edhe përgjigjen se ata le t'i mbajnë për vete, sepse kemi shkronjat tona, pa harruar se turqit e grekët duan të përçajnë shqiptarët.

Edhe poetë të tjerë, pjesëmarrës të punëve të Kongresit të Alfabetit, shkruan në ato vite për gjuhën shqipe. Ndre Mjedja, pjesëmarrës i Kongresit të Alfabetit në Manastir, gjuhën shqipe e vë mbi zërin e bilbilit e erën e zymbylit, se ajo nuk guxon të ndahet, se atë e flasin fusharakë e malësorë, gegë e toskë dhe se te të gjithë është Shqipëria.

Poashtu ky shkrimtar e kujton se gjuha shqipe është nga Tivari deri n' Preveze, e jo si ndonjë shkrimtar që gjeografinë gjuhësore shqipe e shihnin nga Shkodra gjer në Vlorë. Shkrimtari tjetër, Hilë Mosi, gjuhën shqipe e quan si të perëndisë, se është si pranverë dhe se nuk është e mjerë, ngase e rrisin shiptarët atë. Kurse Gjegj Fishta, ndër udhëheqësit e Kongresit të Alfabetit, fton te brohorasin shqiptarët me gjuhën e vet të rrojë Shqipëria.

Kongresi i Alfabetit i Manastirit solli (s)prova shembullore për organizimin shqiptar në saje të një uniteti dhe karakterin etnik shqiptar e specifikoi sipas gjuhës, duke e çliruar nga prangat klerikale.

Poashtu në këtë Kongres për herë të parë morën pjesë edhe femra shqiptare, pastaj vëzhguese ndërkombëtare nga Amerika dhe shoqata biblike e ungjillore edhe nga Britania e Madhe. Kisha ortodokse greke dhe qeveria turke sollën ndalimin e gjuhës shqipe në kisha dhe shkolla, por këtë nuk e përfillën shqiptarët.

Në Elbasan protestuan mbi 7000 shqiptarë kundër shpërndarjes së alfabetit shqip me shkronja arabe nga qeveria turke, në Korçë e qytete të tjera u dogjën mbi 15 mijë botime të këtilla, e kur një grup myslimanësh të Shkodrës deshën të protestojnë në përkrahje të alfabetit arab, mbi 60 mijë shqiptarë të këtij rrethi dhe të Malësisë së Madhe të feve të ndryshme e ngritën zërin kundër

alfabetit arab dhe në përkrahje të abëcësë shqipe të Manastirit.

Kongresi i Alfabetit ose i abëcësë shqipe, ndonëse nuk qe i prerë se në cilin alfabet të shkruanin shqiptarët dhe u la që në të dyja dialektet të shërbeheshin, pra në atë latin dhe atë të Stambollit, përsëri me kohë populli vendosi vet dhe u orientua që të shkruhet me alfabetin latin, sipas parimit një tingull një shkronjë, pra me 36 tinguj e shkronja dhe se si risi ose ndryshim nga ai latin, ishin bigramëshet ~th, ~dh, ~zh e tjerë.

Këtë e bëri edhe për shkaqe praktike, nga e vërteta se makinat në shtypshkronja ishin më rrallë që të shtypnin në alfabetin arab, në krahasim me ato që gjendeshin në Evropë dhe që përputheshin me praktiken e shqipes. Poashtu, me përcaktimin e Kongresit të Manastirit, populli shqiptar alfabetikisht sikur u përcaktua për civilizimin e konstitucionalen perëndimore dhe me këtë sikur lirohej nga sundimi osman shumëshekullor.

Në fund, duhet thënë se Kongresi i Alfabetit bëri njësimin fizik të shumanshëm të shqiptarëve.

Pos që bashkoi nga të gjitha viset, edhe nga të gjitha besimet fetare, bëri që përcaktimi alfabetik të ketë rëndësi shqiptare. Me këtë evitoi vështirësitë për

komunikim të drejtkuptueshëm të shkruesve të letrave shqipe me alfabete të ndryshme.

Në kohën e Kongresit të Manastirit botoheshin rreth 100 gazeta e revista shqipe brenda e jashtë Shqipërisë me alfabete të ndryshme, kurse pas tij të gjithat iu bindën një alfabeti.

Se pati karakter të bashkimit brendashqiptar Kongresi i Manastirit, dëshmon edhe një fakt, me të cilin edhe do ta përfundojmë këtë shkrim: ndërsa Gjergj Fishta, i cili ishte nga Klubi i Shkodrës thoshte në tribunë se këtu kam ardhur ta mbroj jo një alfabet (pra, jo të ndonjë klubi ose krahine), por kam ardhur ta mbroj alfabetin e shqiptarëve dhe të gjuhës shqipe, hoxha nga Shkupi, Ibrahim efendiu, i entuziazmuar për fjalët me qëllimet thjesht shqiptare, me lot në sy rend dhe e përqafon priftin katolik nga Shkodra.

Shkup, 21 nëntor 2010

POSHTËSHËNIM:

Kjo kumtesë u lexua më 22 nëntor 2010 gjate tribunës së Shoqatës së Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, e mbajtur në Manastir për kujtim të kësaj ngjarjeje.

GASPËR GJINI

DHE IPESHKVIA SHKUP-PRIZREN

Shkupi i ka dhënë historisë shqiptare njerëz të mëdhenj të penës, dijes, sportit, bamirësisë, besimtarisë ose pushkës liridashëse. Ndër ta ende e patrajtuar, e pamerituar dhe e panjohur është edhe figura e Gaspër Gjinit (1930-1985), familja e të cilit nga Shkupi njihet si tejet e nderuar.

Gaspër Gjini ka doktoruar në fushën e të drejtës kanonike në Universitetin elitar katolik "Propaganda Fide" qysh në vitin 1968 me temë për burimet historiko-juridike të Kishës së Shkupit, të cilin preokupim e shtjellon të plotësuar dhe e boton edhe në kroatisht. Bën studime panoramike dhe prezantuese te historisë së besimit katolik shqiptar në segmentin organizativ Shkup-Prizren, por që prurjet e tij rrezatojnë me rëndësi kontinuele të historisë kombëtare shqiptare, ngase vendlindja (Ferizaj), vendveprimi e vendjetesa ishin në arealin emblematik të Shkupit, kryeqendër dardano-

kosovare dhe ka rëndësi të paevitueshme mbarëshqiptare.

Në librin e tij "Ipeshkvia Shkup-Prizren" nëpër shekuj, si dhe në disa studime me vlerë të posaçme, të panjohura dhe të patrajtuara deri sot para opinionit, Gaspër Gjini pasqyron e shpjegon lindjen dhe vazhdimësinë katolike shqiptare që nga koha pagane e deri në kohët moderne, sidomos misionin e Shën Palit dhe shpërndarjen e krishterimit iliro-shqiptar, i cili thotë: "Kështu prej Jeruzalemit e rrethepërqark deri në Ilirik e kam kryer posaçërisht detyrën time të përhapjes së Lajmit të gëzueshëm mbi Krishtin". Dardania paraprake e Kosovës së sotme është burim frymëzimi e qasjeje e hulumtimeve të Gaspër Gjinit në trajtesat e tij shkencore, pastaj pozita katolike shqiptare pas ardhjes së sllavëve dhe të turqve në Kosovë, qëndresa shqiptare, laramania, martirët e Karadakut, udhëheqësit organizativë të kishës shqiptare në Dioqezën Shkup-Prizren e shumë pikësynime tjera hulumtuese.

Vepra e Gaspër Gjinit jep përgënjeshtrime bindëse ndaj pseudoshkencëtarëve që mohojnë vazhdimësinë etnike të shqiptarëve në trojet e Dardanisë (Kosovës), sidomos të Shkupit, si ishte mëtimi i Enciklopedisë Maqedonase, e cila shqiptarët e këtushëm i nxirrte ardhacakë në këto troje gjatë shekujve XVI-XVII.

POROSIA EDUKATIVE PËR BASHKIMIN KOMBËTAR E KËNGËVE TË CIKLIT TË MUROSJES

Këngët popullore shqiptare, baladat e legjendat, kanë shtrirjen e tyre në shumë vise veriore dhe jugore shqiptare, të okupuara nga ish-Jugosllavia. Sipas mbledhësve të folklorit dhe tipologjizimit të njësive folklorike në sakrifica njerëzore ose murim, kuptojmë se këngëtari popullor e himnizon ndërtimin e urës ose murit të kalasë, si punë me rëndësi tejet të madhe të përgjithshme.

Këtë herë i dëgjova disa këngë të këtij profili folkloristik nga Kosova, Mali i Zi e Maqedonia shqiptare, edhe toske. Frymëzim i pathënë në këtë cikël këngësh është flijimi, sakrifica, kurbanllëku ose murosja e gruas për qëllime të larta, respektivisht për ndërtimin e urës së shenjtë, që diku mund të dëgjohet e të lexohet si urë e Fshejtit, të shenjtit e ngjashëm.

Tre vëllezërit, në ndonjë këngë është si tre ustallarët, tre hasjanët, tridhjetë ustallarë, bëjnë përpjekje

sizifiane për të ndërtuar urën me rëndësi të posaçme, që mund të ketë edhe kuptimin konfidencial, të fshehtë ose të shenjtë. Mirëpo, u ngec puna në një qemer (këmbë të urës), e cila urë ditën ndërtohet e natën rrënohet, duke i fluturuar gurët e drurët në qiell.

Në fabulë të këngëve të këtij cikli del figura e këshillëdhënësit, i cili herë është plak, herë dervish e herë edhe plak. Këshillëdhënësi u sugjeron se kusht i suksesit të tyre është të murosin, sakrifikojnë ose flijojnë njërën nga tri gratë e tyre. Ndonëse tre vëllezërit ia japin besën njëri-tjetrit se nuk do t' u tregojnë grave të tyre që njëra nga ato do të muroset nesër, dy të mëdhenjtë e prishin besën, kurse vëllai më i vogël e mban, simptomatikisht bëhet hero i ruajtjes së trashëgimisë dhe bartjes së saj te të ardhshmit për amshimin e shenjtërisë së besës, fjalës, premtimit të dhënë, kuptohet me veprën e gruas së tij.

Murosja e gruas duhet shikuar nga aspekti i dobisë jovetanake, por të përbotshme. Nusja vetëmuroset, por vepra e saj merr kontinuitet dialektik në ndërkohësi, deri në ditët e sotme. Ajo me vetëdije niset t' ua dërgojë bukën e përditshme tre vëllezërve punëtorë në urë, me vetëdije sakrifikon jetën për të mirën e kënaqësinë e kunetërve, të burrit, të vjehrrës dhe të fëmijës së saj që po e lë në këtë jetë.

Shpirtgjerësia e nuses për vetëmurosje është më ë madhe, kur kjo i lë amanet (porosi) nënës së vet gjallë që motrën ende e pamartuar, t'ia japë burrit të saj që po e lë në këtë jetë. Sepse, burrë më besnik nuk do të gjejë, por edhe të kujdeset për fëmijën tezja e tashme alias nëna e ardhshme e foshnjës. Në figurën femërore të nuses së murosur gjejmë vetëflijimin e vetëdijshëm e të qëllimtë. Lexuesi bindet se nuk është fjala për flijim të thjeshtë të dikujt (kunetërve) ndaj tjetrës (nuses), por vetëflijim të nuses koshiente të arrijë aspiratën madhore, shpëtimin e më shumë se një jete.

Qasja e këngëve të (vetë) flijimit ka frymëzim nëntematizues nga prizmi i bashkimit kombëtar në aspektin ndërkohor. Personazhet punëtorë kanë brengë të përbashkët ndërtimin e urës, bashkimin e dy brigjeve me pasuri lëndore e shpirtërore të vëllazërisë së gjakut të dy brigjet e lumit ndarës.

Metaforikisht nënkuptohet se karshi vështirësive në punë e qëllime të shtruara nuk duhet të zmbrapset njeriu ose grupi, por të hulumtohen e gjenden ide e mënyra të arritjes së qëllimit. Behja e figurës së plakut këshillëdhënës në fabulë bind se punët e mëdha nuk bëhen pa miq e përkrahës mendjeurtakë.

Plaku gjysmë-njeri e gjysmë - engjëll i bind vëllezërit se e kot do të jetë puna e tyre, bile edhe i këshillon të bëjnë sakrificën (flijimin, kurbanin) njërën

nga rri gratë pas besëdhënies. Objekt flijimi është më e dashura, më e domosdoshmja, më e dhimbshmja dhe më e këndshmja për ta, nusja. Edhe për të vetëflijuarën është ky kusht, duke u flijuar për më të dashurit e saj, burrin, fëmijën, kunetërit, vjehrrën e qëllimin e ndërtimit të godinës

Nga prizmi ndërkohior shikuar, këto këngë sjellin përvojën edhe në kohën më të re. Personazhet e tre ose trridhjetë ustallarëve janë sinonime të popullit që ka punuar për bashkimin kombëtar (ndërtimin e urës, kalasë).

Ura e Fshejtë është vendi që i bashkon trojet e brigjeve (zhbërjen e kufijve të dhunshëm), plaku është simbol i miqve e aleatëve përkrahës e këshillëdhënës si duhet të veprohet, murosja e gruas është gjaku i derdhur dhe sakrifica e domosdoshme për qëllime të larta, nëna (vjehrra) është vendi amë që duhet të kujdeset për kthimin e pasurisë së marrë me dhunë, kurse fëmija është vazhdimësi e qëllimit të të parëve të tij për të dërguar në vend përfundimisht amanetin e të parëve.

Këtë dramë e shikuam gjatë luftës së fundit në Kosovë (1998/99). Në skenë regjia e saj i solli personazhet me rolet e ngjashme si në fabulën për ndërtimin e Urës së Shenjtë (bashkimit kombëtar shqiptar), fabulën dhe kompozimin e saj dhe shthurjen e pagabueshme, symprehtë dhe me dobi të përbotshme

shqiptare. Prandaj, kënga e vetëflijimit me murosje e nuses së re ka peshën e porosisë dhe këshillës ndërkohore shqiptare, se si pa punë me djersë, pa flijim me gjak, pa besëdhënie (pajtim), pa mençuri edhe të miqve aleatë, pa përkrahjen e tyre të sinqertë, nuk arrihet ndërtimi i Urës së Shenjtë (Kalasë), Bashkimit i Kombit Shqiptar.

KËNGA E HASAN AGËS

Nuk është analizuar aq shumë kjo këngë, ndonëse duhet shumë më shumë të bëhet për lirizmin dhe epizmin e saj. Historiku i saj nuk dihet, por kam bindjen se është fjala për një dashuri të dy të rinjve shqiptarë me besime religjioze të ndryshme, por me një dashuri të përbashkët, besnike e të pathyeshme deri në vdekje. Sa ma merr mendja, është fjala për të riun Hasan dhe të rejën Çika Potureshë. "Potur" në anën e Karadakut, Grykës së Kaçanikut e Hanit te Elezit u thonë njerëzve që më vonë janë konvertuar në fenë islame. Pra, duket se është fjala për dashurinë e të riut mysliman dhe të rejës së krishterë. Në disa fshatra shqiptare të Kosovës ka shqiptarë me besime të ndryshme në të, edhe në një lagje, bile edhe në një familje ka njerëz të besimeve të ndryshme. Sido që të jetë, Kënga e Hasan Agës dhe Çikës Potureshë është simbol i dashurisë së patradhëtueshme të të rinjve nga sferat e ndryshme sociale bejlere-fshatare dhe e harmonisë ndërfetare shqiptare.

AGA IMERI

Kënga e Aga Imerit ose me motërzimet titullore të tjera. si Ag Ymeri, Ago Ymeri e tjerë, është tekst i letërsisë popullore që na rrëfen se leht është të japësh besën, por më vështirë është ta mbash atë. Pra, fjala e dhënë, premtimi, besa, jepet për disa sekonda, por është barrë që duhet të mbahet tërë jetën. Këtë krijim popullor e kanë kënduar shumë rapsodë të vjetër e të rinj. Ka disa shtylla që e mbajnë fortë këngën:

1. Dashuria e sinqertë dhe fati bashkëshortor ende pa ia nisur e që ruhet me fanatizëm.

2. Ruajtja e shenjtërisë së besës së dhënë, e cila jo vetëm që e shpëton besëdhënësin, por edhe besëmarrësin. Në një variant të mëhershëm të kësaj kënge përfundohet me fjalinë se Aga Ymerin "nuk e pshtoj e bija e Kralit, por e pshtoj besa e shiptarit".

Kënga është me tematikë historike të periudhës së nizamëve. Besa si "personazh" është i dendur në letërsinë popullore, si Arif Sinani, Konstadini e Dhoqina e shumë të tjera.

SHQIPTARËT NUK JANË KOMB DORDOLEC

ME IDENTITET EVRO-AZIATIK

Nuk ka shqiptar me identitet evropian e amerikan, as aziatik e australian ose afrikan, por ka shqiptar me identitet të mirëfilltë shqiptar.

Nuk ka shqiptar me identitet lindor e perëndimor, as me verior e jugor, as me identitet islam e të krishterë. Këtë bindje e mbaj kur e di se tipari shques themelor në trikohësi i një etnie është gjuha. Së këndejmi, identiteti shqiptar nuk është krijuar për një vit, as për një shekull, as për një milenium, por shumë më tepër se këta.

Nëse heqim dorë nga njëra pjesë e historisë ose gjeografisë shqiptare, identiteti shqiptar nuk do të ekzistonte i plotë, do ta bënim gjuhën shqipe e kombin, identitetin shqiptar që do të ngjante në një pemë me rrënjë e frute, por pa kërcell e trung, gjë që do të ishte jodialektike, jo e traditës së trashëguar brez pas brezi.

Çdo përpjekje për të copëtuar identitetin shqiptar në lindor e perëndimor, mbase të krijojnë një komb shqiptar dordolec me biografi memece sipas "artit" të tyre, ka paragjykim joshqiptar, mbase një ditë do të dalë edhe antishqiptar.

Disa njerëz donkishotianë harrojnë se para feve e kemi pasur gjuhën, historinë dhe, nëse duam ta gjymtojmë identitetin tonë, atëherë duhet të ndahemi në identitet lindor e perëndimor, të kthehemi në komunizëm, në Jugosllavinë antishqiptare, në Luftën e Dytë e të Parë Botërore, të kthehemi në kohën e Pjetër Bogdanit, Sulltan Muratit e të Skenderbeut, të vitit 1054 me ndarjen e besimit të krishter të shqiptarëve në lindorë e perëndimorë, në Vitin Zero, në paganizëm e Iliri, që nuk do të na lejonte askush, mbase edhe ne do ta pengonim këtë hapërim, bile edhe ata që trumbetojnë të kthehen mbrapa do të zmbrapseshin. Me këtë logjikë të tyre, të cilët historinë e konsiderojnë si një orë të tyre mekanike që kur duan ia kthejnë akrepat mbrapa, del se populli shqiptar edhe një herë u dashka të kalojë nëpër ato luftëra të mynxyrshme, të bëjë edhe një herë tkurrjen në vend të thurjes së arealit të meritueshëm shqiptar.

Jemi këta që jemi, me identitet të formuar rreth katër mijë vjet dhe, të këtillë si jemi, kaq sa kemi mbetur ende gjallë, jo që të grindemi ndërmjet vete, por që të duhemi e të ndihmojmë njëri-tjetrin, duhet të bëjmë përpjekje për avancimin e Shqiptarisë pa paragjykime të

ulëta fetare, pa teokraci të domosdoshme egoiste. Shqiptaria i ngjan tre vëllezërve të një gjaku nga nëna e babai i përbashkët; njërin vëlla e ka shtuar Zoti me fëmijë më shumë, tjetrin më pak, një tjetër pak më pak ose fare. Por, që të tre e kanë dashurinë vëllazërore dhe dhimbjen për tjetrin, e kanë të trashëguar nga atësia vullnetin për ndihmë të ndërsjellë, që në dasma e vdekje t'u gjenden bashkë.

Ekskluziviteti mendimor është i stilit komunist të të menduarit mbi tjetrin dhe të lakmuarit vetëm për veten, që të vërtetën as e njeh, as e pranon, bile i shtytur nga kapriciet joargumentuese, lëre që bën dëm kolektiv, por ndoshta do të bindet vetëm kur e keqja ta prekë vetëm atë sajues të së vërtetës së paekzistueshme. Ky ekslkluzivitet mendimor traditën e do pa trashëgiminë, pra selektueshëm e njeh, e jo në vazhdimësi trashëguese, me jashtëkohësi evolutive. Jemi shqiptarë myslimanë, katolikë, ortodoksë, por e kemi edhe një shtresë jobesimtarësh dhe ateistësh që flasin shqip, që edhe ata duhet të konsiderohen si njerëz tanë, të gjakut shqiptar.

E mira e së mirës është të besojmë në një Zot, të shkojmë në kishë e xhami dhe nga mësimet e nxëna aty ta fisnikërojmë shpirtin tonë si kulturë e përditshmëri, të lutemi shqip për mirësinë e mbarësinë kolektive shqiptare, në një gjuhë të vetme në botë, të mos lejojmë që vëllai ynë i besimit tjetër të mos mund të shkojë në faltoren e preferuar, të mos ketë mundësi nga sëmundja

ose censura e kanunit e regjimit të mos mund t' i lutet e falet Zotit me vëllezërit e tij në faltore.

Temat aventuriere mund të përshkallëzohen në marrëzi intelektuale (mjerisht që edhe ndonjë shkrimtar e intelektual e gjejmë në "Vallen e djallit të engjëllosur") nga ithtarët, të bëhen kob, për më tepër nëse në to futen diletantët fetarë, mercenarët antikulturorë, jokombëtarë të gjeoetnisë shqiptare. Edhe nëse rreshtohemi në taborin e një ëndjeje retrogarde të gjithë shqiptarët, nuk ndihmon gjë, përsa nuk e ndërrojmë besimin e përkushtimin në punë, përparim, besim të mirëfilltë në Zot; derisa nuk heqim dorë nga demagogjia e "përparësisë" pa mbulesë utilitare.

Evropa e ka Lindjen e Perëndimin në vete, Amerika e ka Lindjen e Perëndimin në vete, Azia e ka Evropën e Amerikën në vete dhe bashkëjetojnë, i marrin të mirat e i flakin të ligat e ndërsjella, e duan më shumë trashëgiminë drejt së ardhmes se sa të tashmen kah e shkuara. E, pse ne shqiptarët të mos e kemi civilizimin lindor e perëndimor brenda vetes, kur jemi "rritur" me ta historikisht e gjeografikisht, duke ruajtur identitetin rrënjësor shqiptar, si çdo popull tjetër i gjallë sot në botë?

MËSUESI I VYESHËM

ËSHTË NXËNËS I TËRËJETSHËM

Është shpresë e zbrazët se me përfundimin e fakultetit ose shkollës përfundon ëndja për dije. Tejet gjykim i gabuar, demagogjik dhe i njëanshëm, mashtrues, stagnues e retrogard në hapërim shoqëror. Diploma është dokument i pavlerë, po të mos dëshmohej disponimi i saj në jetën e mësuesit, i ngjan njeriut parazit që tërë jetën e ka kaluar në kurriz të tjetrit, është si buleta për të hyrë në kinema dhe aty t'ia krisësh gjumit, e kur pastaj të pyet dikush se ç'behej fjalë në film, të mos dish çfarë t'i rrëfesh. Diploma i ngjan trupit të njeriut pa veshmbathje, pa shpirt e mendje, ose thënë krahasimisht, si t'ia vishnim skulpturës së një injoranti veshmbathjet e Sokratit. Kundërshti e skajshme.

Mësuesi i vyeshëm është nxënësi tërëjetësor, ai që lexon tërë jetën, që e hulumton, e do, e nxen dhe e shpërndan dijen në hap me zhvillimin shkencor, metodik e dituror, që u përgjigjet kërkesave të nxënësve të

mësojnë më shumë. Mësuesia nuk është profesion, por mision, shprehet Eqrem Çabej, ndaj si misionar që është, mësuesi duhet të iluminizojë, të dritërojë mendjen e shkollarit, bile edhe të popullit, sipas mësimit pedagogjik të poezisë së Naim Frashërit – "dhe drit' e diturisë përpara do na shpjerë". Mësuesi duhet të lexojë më shumë se që ka në librat e destinuar shkollorë, të lejuar nga dikasteri shtetëror (Ministria), sidomos në kohën e sotme, kur mundësitë kureshtare të shkollarit janë të shumta për pasurim dituror.

Kryerja e shkollës ose fakultetit nuk është fundi i dijes, përsosje definitive, por vetëm kryerje e një cikli jetësor, mundësim për zënie të tjerëve. Është përdëftuar se metodologjikisht një mësues është më joshës dhe utilitar për shkollarin e nxënësin, kur ai ka dije të gjithanshme dhe selektivisht ndikon te marrësi i saj.

Të kalojë një vit që mësuesi të mos lexojë as edhe një libër jashtë atij të obliguar, në anën tjetër të kërkojë nga nxënësi të mësojë, ose praktikisht të dëgjohet refreni duke thënë se nuk po lexojnë nxënësit, është hipokrizi mësuesore, ngjashëm sikur të kërkohet të fluturojë dikush tjetër, kurse vet përton të ecë në tokë. Praktika kierarkike e potente me prepotencë të vlerësimit të shpërblim-ndëshkimit ia mundëson këtë, mbase ia kushtëzon të bëhet parazit, në shërbim të interesave klanore-mandatore. Kjo ndodh, sepse nuk rezulton merita pas pyetjeve retorike: Ç' bëri ky mësues për

nxënësin, shkollën, rrethin si mësues i popullit? Me se do të dëshmojë mësuesinë e tij substanciale? Vallë, mos është marrë më shumë me punë joarsimore dhe kush e josh dhe e trimëron për këtë? Apo, mos shpërblehet dështaku e i painteresuari dhe pse ndodh ky absurd.

Shembuj se njeriu duhet të kërkojë dijen tërë jetën e kudoqoftë, ka nga filozofia teologjike dhe qysh nga qytetërimi antik; që dija të kërkohet deri edhe në Kinën e largët, ose si ka thënë Sokrati i Greqisë antike, se e di një gjë që nuk di asgjë, që domethënë se dija është e paskajshme, ndonëse të tjerët e kanë konsideruar si më të mençur e më të dijshëm në vend. Historia e revolucione ka dëshmuar se ai popull që është i arsimuar, do të kalojë me më pak pasoja dëmtuese, nëse është i arsimuar dhe i edukuar. Kësisoj, çlirimi i tij, zhvillimi i përgjithshëm, perspektiva më e ndritshme do të jetë e një populli.

Diçka nuk po shkon me sistemin e arsimit në Kosovë. Shkolla fajin e sheh në Komunë e Ministri, këto dy të fundit thonë se shkollat kamë autonomi të arrijnë suksese. Mëkatet e pengesat janë te të gjithë, duke iu u frikësuar maksimës "hiq një kashtë, dalin gjashtë" në mesin e tyre, pra mangësive. Nga ndonjë debat eventual me këta faktorë do të dëshmohej se mësuesit më shumë merren me politikë se me profesionin e tyre, se lexojnë më pak se nxënësit e tyre, se në vend që ta kenë ditarin idol, e kanë gogol dhe se të gjitha këto mbrapshti i lejon dhe i trimëron Komuna e Ministria. Këtij vesi nuk i thonë

atdhetari, por obskurantizëm; nuk i thonë përkushtim, por parazitizëm; nuk i thonë edukatë, por bastardim; nuk i thonë çlirim të shpirtit e të mendjes, por robërim nga prepotenca e stepjes për shkollarin e njerëzinë.

Intelektuali është për nga natyra profil që nuk krijohet me një diplomim në shkollë të mesme, por është kategori shoqërore elitare. Rexhep Qosja kur e trajton profilin e intelektualit të imponuar, mediokritetin, thotë se mediokrët janë demagogë me fjalë shumë, por me mendje të paktë. Intelektuali i mirëfilltë është jokonformist ndaj pushteteve, sepse dëshiron përparime e zhvillime të pareshtura, të cilat i veneron dhe dëshiron të ndryshojë. Nuk është e thënë të kesh vetëm një diplomë e të të quajnë ose të vetëquhesh intelektual, sepse diploma për dikë është vetëm fletëhyrje sociale për punësim ose-ose karrierë iluzioniste. Por, është me rëndësi se çfarë bëjmë për këtë popull e këtë tokë, për të djeshmen, të sotmen e të nesërmen e tyre. Një vendbanim ose një popull mund ta ndryshojë veten nse ka potencë intelektualësh që e duan dhe e përbotësojnë të vërtetën me leverdi shoqërore, që sjell risi riprodhuese të aspekteve shpirtërore e materiale, që puna e tij i shërben njerëzve e brezave. Nje burrështetas amerikan jep vërejtjen se shumëkush pyet çfarë ka bërë Amerika për mua, por nuk e pyet veten se çfarë ka bërë individi për Amerikën. Ballafaqimi i temës në binomin individ -

shoqëri nuk duhet të kuptohet me tabu nga intelektualët, por si mundësi për avancim.

Në librin e tij "Muhamedi alejhi selam sikur ta shihnit" autori Aid El Karni se ky profet ka thënë: Kush e merr rrugën për të kërkuar dituri, Allahu ia lehtëson rrugën për në Xhenet", që nënkupton se dituria është çelës i të gjitha mirësive të synuara. Dhe, nëse duhet theksuar edhe një gjë të profilit të mësuesit te paarritshëm, që është profeti Muhamed, i cili tërë jetën e mësoi popullin me durim e moral vetanak, edhe atëherë kur e përbuzen dhe e dëbuan nga Meka. Nuk do të krahasoja mësuesin profetik me të sotmit, sepse ai kishte edhe dhunti nga Zoti, por vetëm solla shembull se sa mësuesit e sotëm e shpenzojnë kohën për të kërkuar dituri të lëmit profesional, se a bëjnë më shumë mësimdhënie se sa mësimmarrje. Prandaj, njeriu për t'u pjekur intelektualisht duhet të japë sprova në disa faza të jetës, qofshin të diturisë, guximit, flijimit e shpërndarjes së diturisë në atë që e mëson përditë dhe gjatë tërë jetës intelektualiteti i tij të rrezatojë kudo, edhe atëherë kur has në pengesa e mallkime nga hordhitë demagogjike duke ndjerë rrezik civilizues intelektualin. Intelektuali është në luftë të tërëjetshme.

Arsimi është epiqendër e mundësive për zhvillim të shpejtë, si qeveri në vete, kur dihet se aty ka profile te llojllojshme profesionale. Në të ka profile teknike, gjuhësore, gjeografike, historike, kimike, fizike e të tjera

dhe secili mund të bëjë diçka më tepër se mësimdhënia e përditshme. Kjo është praktikë edhe në vendbanimet tjera. Hani i Elezit e ka potencën intelektuale të mangët dhe pikërisht ky fond duhet të bëjë nga vetja diçka më tepër secili në fushën e vet, të bëjë më shumë për vendbanimet e pazhvilluara që të afrohemi te të tjerët. Po e sjell shembullin e një heroi-intelektual, Agim Ramadani nga Zhegra - ai është munduar të japë atë çfarë ka mundur e ditur në shumë fusha për këtë vend e popull; dha shumë në poezi, pikturë, strategji ushtarake e në fund e dha edhe jetën. Ky është njeri nga shembujt moderne se si intelektuali tërë jetën nuk ndalet dhe nuk kënaqet me veten, por jep e nuk kërkon kurrë asgjë. Historia e zhvillimit intelektual dhe civilizues na ofron shumë shembuj bindës se ky profil rrezaton edhe pas vdekjes së tij, ashtu si po rrezatojnë edhe sot krijimet e gjykimet e Greqisë Antike, të Romës, të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, të iluminizmit e renesancës, të Arkimedit, Pitagores, Njutnit, Xhordano Brunos, Ajnshtajnit, Naim Frashërit, Gjergj Fishtës, Fan Nolit e të tjerëve. Këta kanë qenë mësues të mirë, kanë qenë nxënës të mësuesve të mirë dhe normalisht kanë prodhuar edhe nxënës - mësues te ardhshëm të mirë. Sepse, këta njohuritë e reja i kanë kërkuar, mësuar dhe shpërndarë tërë jetën, parësisht te vetja, pastaj edhe te të tjerët.

Mësuesi i vërtetë nuk ka nge për diplomë, sepse ai nuk e punon punën si profesion nga diplomimi deri në pension, mbase atë diplomë duke e shfrytëzuar më shumë për ambicie e karrierë joarsimore, se sa për liderizëm, demagogji e politikë. Mësuesi i vërtetë nuk ka nevojë për diplomë si certifikatë sociale, sepse ai punën e vet e ka me ndërgjegjen e moralin e misionarit të tërëjetëshëm. Pi sjell dy shembuj, njërin nga filozofia antike greke dhe tjetra nga iluminizmi shqiptar. Sokrati që konsiderohej nga të tjerët si mendimtar dhe mësues i popullit, para se të vdiste kishte thënë se e dii një gjë që nuk di asgjë, sepse dija nuk ka skaj as për më të mençurit. Ose, Naim Frashëri, mësuesi e poeti shpirtëror dhe dituror i popullit shqiptar, rëndësinë e mësimet, nxënies, e përkufizon me "…dhe dritë e diturisë përpara do na shpjerë". Këta mësuesisë nuk e kanë ndërtuar me diploma e profesion, por me prodhime diturore si mision.

ZEMËRIMI I DELFINIT NË DJALOSHIN

Ndonëse i ka mbushur të gjashtëdhjetat, gjyshi ynë është njeri tejet i mbajtur. Qysh si fëmijë ia kënda peshkimin. Sa herë që vijmë për pushime në qytetin bregdetar, na merr me vete të peshkojmë. Kur vëren se jemi mërzitur nga rendjet nëpër breg, lë shkopin e njicën dhe na rrëfen nga jeta e përjetimet e veta. Sot diçka ishte i humbur dhe nuk i kujtohej të na rrëfente. Më në fund e vërejti mërzinë tonë.

- Oh, më falni vogëlushët e mi, më falni, - erdhi në vete gjyshi. – Pak më parë pata ndër mend të ju rrëfej, por ja, sakaq harrova. Ah, edhe kjo mendja e plakut për asgjë nuk është.

Ne u gëzuam që gjyshi nuk e harroi detyrën e përditshme ndaj nesh.

- Gjysh, mos e fajësoni veten. Secili njeri harron, - u mundua ta arsyetojë Loni, duke u hequr si i pamërzitur. - Pa na thuaj ç'deshe të na rrëfesh.

- Nuk e di sa do të ju pëlqejë, por desha të ju rrëfej për zemërimin e delfinit shpirtmirë në djaloshin shpirtkeq.

Që të tre i zgurdulluam sytë dhe here-herë dyshonim mos gaboi në të folur gjyshi. "Zemërimi i delfinit shpirtmirë në djaloshin shpirtkeq", e përsëritëm habitshëm në vete. Këtë e vërejti gjyshi, i cili e vazhdoi rrëfimin.

- Këtë që po jua rrëfej e pata dëgjuar nga gjyshi im, edhe ai i dhënë pas peshkimit, - sqaroi pasi i la veglat e peshkimit në një të çarë shkëmbi. – Në kohë të lashtë një djalosh ishte grindur me prindërit dhe, i zemëruar kishte dalur të lahet në plazh. Sakaq qenka trazuar deti dhe djaloshin e rrëmbejnë valët. E shpijnë në thellësitë më të mëdha. Lufta me valët e detit bëhet gjithnjë e më e padurueshme për djaloshin. Në çastet kur po merrte frymëmarrjet e fundit, djaloshin e pa një delfin, i cili me shpejtësi të rrufeshme erdhi, e futi në bark të vet djaloshin dhe e nxori në breg.

- Pse, nuk e hëngri delfini djaloshin, gjysh!? – nuk e la kërshëria e madhe Lonin pa e pyetur.

- Përkundrazi, - u përgjigj shpejt dhe i mbushur në frymë gjyshi, si të frikohej mos po e harronte rrëfimin. – Pasi e nxori në breg ai i tha: "Djalosh i mirë, shyqyr që shpëtove gjallë! Tash shko në shtëpi dhe bindu në

urdhrat e këshillat e prindërve. Je i lirë", e udhëzoi delfini djaloshin.

- Bile ai e paska ditur edhe për grindjen e tij me prindërit.

- Me kaq përfundoi rrëfimi për djaloshin lozonjar dhe delfinin.

Nga pyetjet e shumta gjyshi kuptoi kërshërinë tonë.

- Jo, ende ka dhe do të bindeni si djaloshi ka bërë gabim ndaj delfinit. Ai në vend që t'ia kthejë me të mirë gjestin shpëtimtar delfinit, nisi të mendojë keq e më keq për të, kur delfini i lodhur gjysmë në deti e gjysmë në breg u shtri të pushojë, bile edhe gjumi e kishte zënë. "Do të kem mish të mjaftueshëm për tërë dimrin", llogariti djaloshi duke e shikuar atë kah flinte. Me shigjetë e vrau delfinin!!! Me të dëgjuar për vrasjen tradhtare të delfinit nga ana e djaloshit, i mllefosur u tubua farefisi i viktimës dhe e pleqëruan punën. "Ushqe korbin të t'i nxjerrë sytë", e cilësoi delfini më i vjetër dhe më i urtë këtë krim. Që nga kjo vrasje delfinët e humbën besimin në disa njerëz, - e përfundoi rrëfimin gjyshi.

Mbetëm të kënaqur me rrëfimin e gjyshit, por si pa gojë nga tradhtia e djaloshit ndaj delfinit. Pasi ishim njerëz, e ndienim veten të fyer. Delfini na u dhimbs pa masë, si ta kishim shok të klasës a të lagjes. Rrinim galuc

e të menduar një kohë të gjatë pas përfundimit të rrëfimit të gjyshit, bile edhe mbrëmjen që kishte pllakosur mbi kaltërinë e detit që e kishim para nesh, nuk e kishim hetuar. Të mos kishte qenë zëri i gjyshit të na thërriste, kush e di kur do të vinim në vete.

Puhia e mbrëmjes sikur na ngushëllonte rrugës.

FRAGMENTE NGA ROMANI NË DORËSHKRIM

(1)

Idila shpesh vriste mendjen nëse ishin më të shpejtë mendimet ose treni që udhëtonte drejt veriut. E, nëse i prishen rrotat trenit, rrugën do ta vazhdoj më këmbë, mendoi e parabetuar. Ai, i vetëtiu mendja te ardhësi drejt saj nga ana tjetër, protagonisti i fatit, është nisur dhe duhet të takohemi. Pikëpjekjen e krahasoi si ditënatën e saj, gati të përditshme; sa më shpejt i ikte natës, i afrohej agimit. Pra, sa më shumë i ikte jugut, i afrohej veriut. Por, ja që e kishin lënë të takohen në mes të gjeografisë së tyre, që i dukej shpirtërore dhe shpresëdhënëse.

Me të mbyllur fletoren, sikur hapi një libër kujtimesh e përsiatjesh për dashurinë e tyre. I kujtoheshin fjalët e ëmbla thënë njëri-tjetrit; të kam shpirt, të kam xhan, të kam hëna 24, të kam diell që më

ngroh shpirtin, të kam vetvetja ime, te kam orë me akrepat që sillen e përsëri vijnë në nismën e dashurisë. Më shumë i kishte pëlqyer fjalia e tij "TË KAM FRYMËMARRJE". E kur e kishte pyetur se pse më ndjente si frymëmarrje, i kishte shpjeguar se e donte si frymëmarrjen, sepse çdo gjë i dukej pak. Frymëmarrja nuk ndalet edhe kur je zgjuar ditën dhe kur fle natën. Pra, njëzet e katër orë, ditënatë më dashka, u bind Idila.

Në prehër mbante një fletore me kopertina të forta dhe skiconte si dy hije njerëzish të njëjtë, gjysmë trupa që kur mbylleshin fletët, bëheshin një. Në mes të trupave kishte vënë një si rreth me shenjën NDAL! Për inat të atyre që nuk duan të bashkohemi, kemi vendosur të bashkohemi. Për inat të atyre që deshën të na ndrydhin e të na zhbënin nga koka e këmba, kemi vendosur të bëhemi një, mendonte me vete Idila. Iu kujtuan fjalët e tij se dashuria jonë është me dy pjesë, si dy dialekte të një gjuhe të mirëkuptimit. Iu kujtuan edhe fjalët e tij se do të nisej nga majëmalet dardane në të njëjtën kohë, kur kjo do të nisej nga bregdeti kaon dhe do të takoheshin në Qytetin e Elbit, aty ku do të bashkoheshin trupat e tyre, mu aty ku takohen e nuk ndahen dialektet e gjuhës së dashurisë. Ai i kishte thënë se në Qytetin e Elbit do të fundosej maja veriore në thellësitë e fund detit jugor. Kur kishte dëgjuar këto fjalë të ëmbla të tij, Idila ia kishte kujtuar një thënie të poetit liqenor, që sikur të bashkohej energjia e veriut me ëmbëlsinë e jugut, do të ishte komb i

përsosur. Pra, edhe dashuria jonë kërkon të shkrijë në një energjinë me ëmbëlsinë.

Ajo ndjente padurim të takohej me të. Kishte ditënet e muaj që në çdo hap i parafytyrohej Idili. Si të ishte ai hyjni, i dukej. Shpesh i vinte një siguri në bindje e shpirt se nëse nuk realizohej bashkimi i tyre, bota mund edhe të zhbëhej, se rregullat hyjnore të dashurisë do të humbnin besimin te njerëzit. Dashurinë tonë e ka krijuar Zoti dhe ai e ruan dhe do ta bëjë, ishte bindur. Ndaj, atë e donte edhe si Zot. Iu kujtua fjala tot ose totem, por pak i dukej ta ndjente si totem alias zot(i)em.

E bluante në mendje si do të dukej bashkimi i tyre në dhomën e vetmuar, ku vetëm ai, ajo dhe Zoti dëshmitar i dashurisë së kthyer, do të ishin në të. Më nuk kishte çfarë do të fshihnin nga tjetri, do të jepnin e merrnin çfarë kishin dhe kjo i shërbente shkrirjes së energjisë në ëmbëlsi. Do t' ia jepnin mrekullitë tjetrit, ato qe Zoti ua kishte falur për tjetrin e për askë tjetër. Do të përshkojë trupin e tij nga koka në këmbë, edhe ai timin. Trupat tona do të ishin gjeografi e dashurisë, e ndaluar deri më tani me kufi gjemborë, por ja që të gjitha i thyen dashuria. Do t' ia shërojmë plagën tjetrit. Trupat tona të zbuluar për dashuri të përmallshme, do të dukeshin si shëtitore për vendet e tyre të dashura, ndonëse të panjohura e të ndaluara deri në ato çaste. Ai do të ecë duke nuhatur skutave të saja, por të papara të kopshtit jugor, kurse ajo do të ecë gëzueshëm e kureshtar polit

verior. Edhe trupet e tyre i ngjanin një reliefi gjeografik, me kodra e fusha, gropa e kroje, por mesi, ku ishte Qyteti i Elbit, ishte një basen ku fshiheshin thesare e mrekulli, në të cilat do të rrokullisej maja e trinisë së vetme të ekstazës së njësuar.

Do të kënaqemi me mesin e pakrahasueshëm të trupit tonë në njësuar. Çdo gjë që prek e nuhat, do të jetë e ëmbël, e dashur, e bekuar, e përjetësuar, si dashuria. Aty do të jetë zjarri i dashurisë, në qytetin e Elbit. Aty do të shkrihet maja bjeshkore në thellësitë detare. Në qytetin e Elbit do të shkrihen në një era e vakët e jugut dhe fresku gati i acartë i veriut. Aty do të jetë trupi i bashkuar në trininë e shpirtit, të trupit e të mendjes. Aty ëndrrat e Idilës dhe të Idilit do të jenë zhgjëndërr e vërtetë. Aty djersa dhe zjarrmia trupore, sintaksa e ëmbël, shikimet bredharake të trupit të paparë deri tani, prekjet në çdo pore të trupit, miklimet, puthjet e uratat e ndërsjella do te krijojnë mrekullinë e dashurisë. Aty Idili e Idila do të përjetojnë orët e shpëtimit të dashurisë, të premtimit të vonuar.

Ndërsa nga dritarja e kupesë së trenit shihte natyrën dhe mallkonte se kjo ishte e paprekur, ashtu si i dukej e paprekur nga njeriu që e do trupin e saj, ose më thjeshtë thënë, ashtu si nuk e kishte parë e prekur me dashuri trupin e tij, nuk e kishte vërejtur se treni ishte ndalur në stacionin e Qytetit Elb. E përmendi një e prekur e lehtë në supin e djathtë.

- Shpirti im i ëmbël, erdha të bashkohemi, - i foli njeriu me buzëqeshje ngadhënjimtare nga një rrugë e gjatë dhe e mundimshme. - Erdha ta përjetojmë dhe të përjetësojmë bashkë stinën e pestë.

Idila ngriti kokën lart dhe e pa një si hije hyjnore para saj, një mrekulli jetike të dëshiruar ta ketë pranë pashkëputshëm.

- Ooooo, Idili im..., - klithi me sa zë pati Idila dhe iu hodh në krahëror.

Nga sytë e tyre faqeve të skuqura pikonin lot gëzimi për bashkimin.

** POSHTËSHËNIM:*

Ideja për të shkruar romanin e dashurisë të të rinjve nga anë të ndryshme shqiptare, është që nga koha e jetës studentore. Këto ditë, duke kërkuar një dorëshkrim, më ra në dorë fletorja, në cepin e së ciës kisha shkruar edhe idenë. Atëbotë kisha shkruar titullin "Hëna 24", kurse sot e kam edhe një ide titulli "Stina e pestë".

FRAGMENTE NGA ROMANI NË DORËSHKRIM

(2)

Kishte mbyllur librin që e lexonte dhe kishte tretur mendjen diku, ku as vetë nuk e dinte, sepse i kishte vetetirë sa hap e mbyll sytë. I ishte shpërndarë duke u bërë copë e grimë. Më kot e kërkonte, si bariu lopën e humbur në errësirë. "Ndoshta do të vijë vetë", u ngushëllua, duke ndjerë se mendimi i tretur i ishte bërë pykë në zemër.

Pranë librit të mbyllur në tavolinë i ra një pikë, e cila u shpërnda në disa pjesë më të imëta. U habit si ndodhi ndërlidhja e pikës me mendimin. I ngjanin njëra - tjetrit me shpërndarjen e tyre. Ngriti kokën lart mos ishte ndonjë shurrë zogu, por nuk kishte përreth pemë, ku rëndomë bënin pushim shtegtarët e qiellit. Mendimi i iku i shpërndarë, pika i erdhi e shpërndarë.

U përpoq të bashkojë pjesët e katandisura të pikës dhe vetëvetiu krijoi një si hartë të njohur e të dashur mbi tavolinë. Mori lapsin dhe e nënvizoi hapësirën ku shtrihej territori i pikës, sepse dronte nga erëligat mos ia thanin gjurmët. “Le të dihet ku ka qenë shtrirja e saj gjeografike, le të dihet”, e udhëzoi veten qortueshëm, duke ia kujtuar rastet kur pakujdesia shumë ide ia kishte tretur, si mendimi i para disa çasteve, të cilin nuk e kthente dot. Me të vërtetë, nuk kaluan as pesë minuta, vendi ku shtrihej pika nisi të përthahej. Vetja iu duk se ka nisur të mbushet mend.

Pika nisi të përthahej anësh dhe në fund në mes të zonës së lagur mbeti më e qëndrueshme dhe këtë nuk e linte të zhbëhej, duke e lagur me pika uji nga gota që e shoqëronte kafenë espreso. E njomte prore, shpëtimin e saj e shihte te njomja, te pikëza e lagësht.

“Sa të më punojë laku tërë jetën nuk do të ndalem duke vënë pikëza si pyka lëngu në mesin e saj, të dihet se është pjellë e trashëgimi imja kjo vepër”, sikur betohej para Hyjit. Pra, me pikëza mëtonte ta shpëtonte pikën.

Kafenë e konsideronte mik më të dashur, recensent e redaktor, kritik e botues të devotshëm. Krijimet e para letrare sikur ia lexonte së pari asaj, sikur edhe lejen e parë e merrte nga ajo, nëse kishte cilësi ose jo.

Si të lirohej nga ndonjë ankth i gjatë trishtues, kur mori lapsin dhe shkroi diçka në margjinën e zbrazët e të bardhë të gazetës. Pastaj hoqi nga xhepi i sakos fletoren e vogël të shënimeve dhe shkroi: PIKA DHE MENDIMI I HUMBUR JANË SINONIME.

Mori frymë më lirshëm dhe, ngadalë-ngadalë nisi të shkruajë atë që kishte ndër mend ta bënte para se t' i ikte mendimi, bile tani edhe ia plotësoi pika. Fill tashë e kishte kuptuar se ishte dashuruar në pikën, bile në mesin e saj, ku i pushonte sovrane dashuria dhe joshja. Nga të gjitha anët, shkurt e shqip thënë, nga koka e këmba e shtypnin pikën, e përthanin erërat e pabesa, armiqësore e zhbërëse. Por, më besnik dhe më i dashur i ishte mesi, i cii ende nuk ishte arritur të përdhosej nga askush.

U kënaq kur u bind se mendja dhe pika ishin me fat të përbashkët. Sërish e mori lapsin dhe e skicoi hapësirën fillestare të pikës. Të dihet ku e solli perëndia për herë të parë, të dihet se erërat e egra ia zhdukën trojet.

Nga çanta nxori një letër të bardhë dhe në të nisi ta vizatojë pikën e kopjuar nga tavolina. Njësoj ishte, por disi të zmadhuar. Brenda territorit fillestar të pikës vizatoi një vashë të bukur, si floçkë e dashur ishte. Nga ana e shkrimtarit u thonin Loçkë figurave të bukura e të dashura. Kishte bukurinë e Hirisë, që në disa anë edhe Hyri i thonin. Brenda shtatit të saj vizatoi lumenj, male,

liqene e dete, ca valë si ajër të pastër, miniera ari. I ngjante një harte që shfaqte përplot pasuri (nën)tokësore e qiellore. Bukuroshen e vizatuar brenda pikës fillestare nga këmba e koka e bëri me ngjyrë më të vrrugët, sikur ishin gjymtyrë të flakura andej-këndej, por që secila ishte si njëra-tjetra. Nën vizatimin shkroi: EDHE TË KËTILLË, TË MANGËT E GJYSMAKE E DUA, SEPSE ËSHTË DASHURIA IME E SHENJTË.

"Me këtë vizatim dua që pasardhësve të mi t' ua lë si dhjatë, se kam dashur një Hiri që ma përdhosën erërat fqinje. Quajeni gojëdhënë, legjendë, histori, E vërtetë, si të doni quajeni, por ky është fati i pikës, i mendimit të humbur dhe që ma ktheu pika, i shtatit dhe shtratit të dashurisë sime të parë të shenjtë", ëndërroi me sy të hapur, sikur i përgjigjej pyetjes së kamerierit se ç' po bënte.

U ngrit i lehtësuar që e rigjeti mendimin e tretur, edhe njëherë duke e shikuar pikën e lëngët dhe kufirin e hijes së saj fillestare në tavolinë. Sikur ia lëvizi qortueshëm gishtin tavolinës: "Mos më tradhto!"

Pikën më nuk e ndjente pykë, as peng i së nesërmes. Një puhi e re, e lehtë e përlau kafenenë e buzëlumit, pra edhe tij. Sikur mori me vete porosinë e shkrimtarit që ta shpërndajë lajmin për rigjetjen e pikës, të vetes…

Ende pa bërë hapin e parë, para tij pa poetin që në qytet njihet se e kanë çmendur në qeli. Atëbotë, pra rreth 25 viteve më parë, kur e kishin futur në birucë, flitej se e kishin burgosur pse e kishte vizatuar një si hartë të krijuar si kjo pikë.

"Ehu, edhe ti paske vizatuar si unë. Një shije, një mendje, një fantazi paskëshim. Oh, më fal, shkrimtar, më fal që e krahasova veten me ty. Eh, i marri që jam, një I koti si unë, të kem një mendje me ty. Më fal! Do të më falësh, poet? Të lutem më fal, por ja që një vizatim e kemi, një pikë të njësojtë! Më fal që të pengova!" dhe nisi të largohet.

Shkrimtari e kapi për krahu dhe e uli në tavolinë. Ndonëse deshi të ngritej, përsëri u ul me të sapoardhurin e ***çmendur në qeli pse e kishte vizatuar pikën në formë të hartës imagjinative. Ndejtën edhe rreth një orë, me bisedë plot seriozë, duke e shikuar pikën e vizatimin, Hirinë e vizatuar brenda hijes së pikës që kishte marrë trajtën e një harte.***

(Skicë për një prozë më të gjatë)

KUJTIMI PËR XHAXHAIN

- Më the se ishe tretur në përsiatje, bile as edhe dritën e ditës nuk e kishe vërejtur, - e pyeta kureshtar, me një dozë dhimbjeje pse e shihja si të tretur e të shpërndarë njëkohësisht në vete dhe jashtë tij.

- Po. Para një ore kishte dalur drita, - më foli sikur si të mos më kishte pranë. - Nuk dija kë ta akuzoja e ta pyesja mos e patë veten time. Agmia e diellit dhe vetja nuk ishin fajtore pse kisha humbur veten, por fajin e kërkoja diku tjetër.

- Diku tjetër?!

- Në kompjuter ishin futur të vdekurit e të gjallët e botës e të pas jetës, - nisi të flasë, këtë herë duke më shikuar disi më përqëndrueshëm. - Me ta bisedoja, grindesha, krekosesha, ankohesha, shahesha, herë kërkoja ndjesë nga ata, herë ua falja mëkatet. Ma kënda të shtroja në studion e krijimit intelektual birra të Sh., por

u kujtova se kisha vizituar vendet e shenjta dhe nuk më lejohej të bëja mëkat të këtillë me fajin dhe dëshirën time. Sidoqoftë, pija sikur edhe gotat ose bardakët e qelqtë, si ma kënda t'i quaja ato. I zbrazja si të pija me të vdekurit dhe të gjallët që sorrollateshin në kokën dhe kompjuterin që sapo e kisha marrë, jo birra, por ujë të thartë, të cilin e kisha mik shoqërimi qyshkur para gjashtë vjetësh isha sëmurë nga veshkët.

- Mbase nga ndonjë ftohje? – e pyeta sa për të mos fituar mbresa se nuk po e dëgjoja me vëmendje.

- Ftohja e tyre, - nisi të flasë pas një kujtese, - ndodhi kur fjeta në malet ndërmjet Miratocit e Llojanit, duke pritur të merrja lejen nga truprojat që të kaloja kufirin. Atë ditë kisha parë varganin me njerëzit që i lëshonin shtëpitë e tyre jetike për të shpëtuar jetën. Ishim shtatëdhjetë deri në tetëdhjetë veta, burra e gra, pleq e plaka, të rinjë e të reja, më së shumti fëmijë. Pasi kaluam postbllokun e fundit policor e ushtarak në fushën e hapur të Miratocit, një ushtar që hiqej i dehur, i urdhëroi gratë e pleqtë të ecnin përpara dhe na ndali burrat për pushkatim. Atëbotë i pashë sytë e ushtarit, nga të cilët do të vinte vdekja për njerëzit e varganit, si kisha mësuar nga titulli i një shkrimtari akademik. Edhe ky shkrimtar e kishte kaluar kufirin tebdil, bile edhe mjekrën e kishte rruar, pata dëgjuar më vonë. Tek ecnim fushës parakufitare, deri sa arritëm te ushtari që donte të na pushkatonte, më kujtoheshin njerëzit nga Prokupla,

Vranja, Çamëria që i kishin lëshuar pasuritë e tyre lëndore dhe një pjesë të ndërgjegjes. Vallë, kishin mbajtur edhe ata fëmijë si njerëzit e këtij vargani, paratë e fshehura ku është më së keqi që t'u gjenden rrugës pa krye? Vallë, kishin shpresuar edhe ata se do të kthehen përsëri në shtëpitë e tyre?

- Edhe te këto gjëra të shkonte mendja në ato çaste hamletiane?, - e pyeta që të ndërprisja breshërinë e pyetjeve retorike, si do t'i cilësonte ndonjë teoricien letrar, të cilat do të mund ta tretnin në humbëtirën e përsiatjeve.

- Hë, hë, - bëri si të më thoshte "sa pyetje naive më ke shtruar?", - Zbrazja e poleve shqiptare në jug e veri më dukej si puna e njeriut që për të shkulur rrapin, pasi ia presin degët dhe ia rrëmihin rrënjët nga jashtë brenda, që një ditë, kur të dobësohet fare rrapi, (pra ,ky popull), me një shqelm mund ta plandosin për të mos mbirë kurrë. Çasteve kur e mbushte pushkën ushtari për të na vrarë, edhe mua në turmë, m'u kujtua nëna dhe e bija, Fitorja. Ajo do të priste birin e saj, (sugarin e nënës), që ta përqafojë mbase për herë të fundit. Shumë kosovarë të dëbuar nga lufta i kishte strehuar në shtëpinë në Shkup, por biri i saj nuk arrinte dot. Në vend të tij, pra mua, mund t'i arrijë lajmi për vrasjen nga ushtari që më rri kundruall disa metra larg. Nuk më lente të qetë mendimi si do të dukej qëndrimi i një

fisnikeje që burrërisht rrit jetim të mitur dhe në fund jeta e tij kushton sa një plumb.

E merrja me mend që nëna nuk do të qante para motrave, vëllezërve, gruas, fëmijëve, por këtë do ta bënte pasi të flinte ose në ndonjë vend të fshehtë. Nuk dija që kishte qarë ndonjë herë ajo, (as kur i kishte vdekur burri), sepse të gjitha vuajtjet i mbante në shpirt si me dry mbyllur. Por, këtë herë do të qante në vetminë e fshehur. Ngushëllim i vetëm në këto çaste ishte kur më farfuriti mendimi se ajo nuk do të jetë e vetmja nënë dikur e sot që ua ka përpirë lufta fëmijët.

- E, të gjorat nënat tona, ç'mos kanë përjetuar dhe, përsëri janë dëshmuar se janë më burrëresha se burrat.

- Ke të drejtë, miku im i dashur. Edhe nënat nga Vranja, Prokupla, Tivari, Çamëria e kanë përjetuar vrasjen e fëmijëve të tyre. Nëna ka pasur lehtësi që nuk ia vrasin djalin para syve të saj, si ka ndodhur në disa kohë e vise. Kurse Fitorja…,

- Çfarë… Fitorja?

- Fitorja, bija ime, fëmija i parë nga katër, do t'u thoshte motrës dhe dy vëllezërve të saj se e kemi pasur një baba që kurrë në jetën e tij nuk ka parë dritë të bardhë; i rritur jetim i varfër, me shqetësime policore e ushtarake gjatë studimeve, punës, ushtrisë. Kështu do t'i mësonte nëna nipërit e mbesat e veta për djalin e saj më

të vogël nga të tretë, për babain e fëmijëve të njeriut që qëndron para tytës së pushkës së ushtarit që do ta vrasë, e Fitorja, si fëmijë që i përjeton gjërat, më vonë do t'i kuptojë dhe do t'u rrëfejë dy vëllezërve dhe motrës, që të tre më të vegjël.

- Je miqësuar me kompjuterin, - fola sa për të prishur monotoninë, kur shkrimtari kishte mbështetur faqen e djathtë të kokës në pëllëmbë dhe kishte përqëndruar mendimin në një pikë që nuk e kuptoja dot.

- Ky kompjuter është i vjetruar, por më shërben, - rrëfeu shkakun e miqësimit me kompjuterin. - Më mirë që është i vjetër, se duke punuar ngadalë, nuk do të sajoj gabime në daktilografim, bile edhe më pak do të bëj rrëshqitje drejtshkrimore nga pakujdesitë ose ngutjet gjatë të të shkruarit. Bërë e gjetur kompjuteri i vjetruar i sotëm që të jem i saktë në gjykimet me të gjallët e të vdekurit. Mos bëftë për asgjë tjetër, e falënderoj kompjuterin e sapo marrë pse ma kujtoi një përkufizim qesharak të xhaxhait. Atë, kur shpesh e pyesnim ç'është gruaja, përgjigjej: "Gruaja është si një vegël pune që nuk bën burri i martuar pa të, qoftë edhe plak", na përgjigjej xhaxhai me humor, duke lëmuar mjekrën e pastër. "Edhe gruaja jote është vegël?", e pyesnim kureshtarë dhe gazmorë ne nipërit e mbesat e tij. "Po, vogëlushët e mi, ajo është vegël që e kam mirëmbajtur pas çdo përdorimi", përgjigjej dhe qeshte… "ha,ha, haaaaa…!" Kur u rritëm, edhe më mirë i kuptonim fjalët e xhaxhait

se ai kishte folur me dy kuptime. I pari, kur ishim fëmijë na dukej interesant krahasimi i gruas me veglën, por kuptimi i dytë ishte se kur u rritëm, e kuptuam se vegla paska shërbyer për shumë punë.

- Kështu ke gjykuar?

- Ashtu edhe sot gjykoj. Vegla e tij, si shumë gra shqiptare, paska shërbyer për të organizuar punën te gratë e familjes së tyre të madhe tridhjetëanëtarëshe, për të mbajtur rregullin në shtëpi, pastërtinë, harmoninë midis kunatave të anëve të ndryshme si më e madhja që ishte, për të lindur fëmijë, rritur e kujdesur për ta. Kjo ishte "vegla" e xhaxhait, që edhe kunetërit, nga nderimi që kishin për të, gati e konsideronin si nënë. Kurse ne fëmijët, pra, fëmijët e kunetërve të saj, edhe e quanim Nëna e Madha. Kur sot takohemi nipërit e mbesat e xhaxhait të ndjerë, disa edhe kanë vdekur nga sëmundjet nduarnduarta, disa i mori edhe lufta, kur pyesim për burrat e gratë, i themi njëri-tjetrit: si e ke veglën? …E kuptove rrëfimin?

- Si jo, po të ndjek me kënaqësi, - iu shpreha me njëmendësinë më të madhe. - Kryesorja që të ndjehesh mirë kur më rrëfen, të mos lëndohesh shpirtërisht. Mund të pushosh, merr ndonjë gllënjkë e pi! Nëse nuk je lodhur, mund të vazhdosh me qejf.

- Të falem nderit!, - e tha me skofiari që vetëm te artistët me un të pastër mund të vërehet. – Sot, njëzet e pesë vjet nga vdekja e tij, kujtohemi në ëmbëlsinë e fjalëve të xhaxhait, me të cilin kushërinjtë bisedonim më lirë se me baballarët. Babuç e thërrisnim. Kurse, gruas së tij, edhe kur i bënim ndonjë sherr, na i përkëdhelte flokët neve, pra fëmijëve të kunetërve.

Babuçi na tregonte edhe rrëfime të tjera nga jeta e tij dhe të të parëve, nga të cilët i kishte dëgjuar. Kur fliste për luftërat, e ulte zërin, sikur dronte mos po e dëgjonte dikush nga rruga, duke na këshilluar që këto të mos i tregojmë gjithkujt. "Bijtë e mi, mbani mend këto që po ua them, se do të ju duhen në jetë! Pushteti i ka futur hundët, veshët e sytë kudo, nuhat, dëgjon, shikon dhe ndërmerr shumëçka", na thoshte duke tundur kokën dhe duke lëmuar mjekrën e bardhë dhe të pastër.

Pasi e bënte pushimin e të folurit, mbase lodhej, ndërsa ne fëmijët e dëgjonim dhe me padurim e prisnim çfarë do të thoshte në vazhdim.

- "E dyta, ata nuk kanë besë dhe janë rrenacakë." Kështu fliste sidomos kur rrëfente për krimet që kishin bërë në fshatin e tij në tetor të vitit 1912, kur i kishin vrarë 15 veta. E dini se ç' ironi kishte ndodhur me këta të vrarë? Unë punoja në hekurudhë, kur një punëtor serb më pati treguar se ky vend quhet me emrin e barbarëve Gjenerali Jankoviq. Sapo ishte larguar Turqia, më kishte

thënë ai punëtor i moçëm diku thellë nga Serbia, Armata e Tretë Serbe kishte dhënë Urdhëresë për "pastrimin e vendit nga armiqtë e shtetit".

Mbështetur në këtë, kishin vrarë shumë shqiptarë, pra edhe në fshatin tonë. Ky gjeneral që e kishte emrin Bozhidar dhe që kishte bërë plojë mbi shqiptarët e këtushëm, kur lëshohet treni për herë të parë nga Sh. për në K., udhëtoi me të dhe regjimi barbar për hirë të tij ia vë emrin vendbanimit Gjeneral Jankoviq. Pra, edhe të vret, edhe ta ndërron emrin e vendit, kishte rrëfyer punëtori i ardhur nga Serbia thellë! Në vitin 194... në fshatin fqi i kishin vrarë rreth 130 veta "ata të Karadakut", si i quante. Bile të vrarët e të dy krimeve i njihte me emër e mbiemër. Të gjallët, që kishin ikur nga ky fshat, i kemi mbajtur me ushqim e me shtroje me javë të tëra. Edhe pse shtëpia jonë ishte e madhe, kishte shumë gra e fëmijë, ndaj dikush duhej të flinte edhe mbi maxhen e miellit. E kuptove rrëfimin deri këtu?

- Po, si jo, - sikur erdha në vete kur më pyeti, sikur unë ia zura vendin në humbëtirën e përsiatjeve dhe atë e nxora në jetën reale. – Vetëm vazhdo, të lutem, nëse nuk të vie zor!

- Edhe kompjuteri për mua është vegël që nuk bëj dot pa të, mu si gruaja që ishte vegël për xhaxhain. Mund t'i hyp kompjuterit e të bëj ç' të dua me të e të mos më hidhërohet, sepse e kam vegël pune, si gruan. Edhe

unë e mirëmbaj pas çdo pune me të. Disa herë e kam uruar: "Të falem nderit, kompjuter, që po i duron tekat e mia! Grua më të dëgjueshme nuk do të mund të gjeja si ti, po të kërkoja edhe me strajcë e skutaçe.".

- Ndonjë kujtim tjetër për xhaxhain…?

- Xhaxhai kishte mendime të papritura dhe tejet interesante. Një të këtillë e kishte thënë edhe për mua, kur isha në gjendje tejet të padëshirueshme. Tre vjet para trazirave studentore qesh regjistruar në Fakultetin e Gjuhës. Më flente në zemër kjo lëndë dhe, sikur u dashurova në të. Kjo ndodhi kur ikja nga shkolla.

Gjatë kohës sa duhej të isha në shkollë, rrija në parkun e afërmë dhe lexoja vjersha patriotike të shkrimtarëve tanë. U mishërova në letërsinë aq, sa e urreja matematikën. Ndaj, studimet i nisa në drejtimin gjuhë e letërsi. Më kupto, jo gjuhë shqipe e letërsi, sepse më shumë kishim provime nga gjuhët dhe letërsitë joshqiptare. I shihja bibliotekat e katedrave gjuhësore të tjera përplot libra e botime kohësh, zhanresh e gjinish të ndryshme, kurse kësaj tonës i mungonin edhe botimet e autorëve tanë. Një ditë e mora letrën dhe ia shkrova Ministrisë së Arsimit të Sh., duke i kërkuar romanet më të rinj të I. K. Letra kishte shkuar në T. Pas disa muajsh nga posta më erdhi një pako, të cilën e mora.

Kishte libra në të, disa romane të I. K. që m'i kishin sjellë nga T. Por, pasi kaluan disa javë, më erdhi thirrja nga policia për "bisedë informative".

Në pyetje më mori punëtori i sigurimit që fliste gjuhën tonë. I interesonte se si e kisha shkruar letrën për në T., pse të kërkoja mu ata libra. Pas një viti, fill pas trazirave të studentëve në P., natën kur kryepolici S. D. po jepte numrin e të vrarëve në protestat e K., përsëri thirrje në polici. Dy herë nuk i isha përgjigjur thirrjeve. Meqë me dokumente isha shpërngulur në K., mendoja se objekt i policisë së atjeshme duhet të jem.

Lutjeve të nënës që të shkoja në polici, meqë tri herë na e kishin bastisur shtëpinë ditën e natën, nuk iu përgjigja me përbuzje. Për çudi, gjatë një bastisjeje në tavolinë kisha pasur makinën e shkrimit të shokut tim dhe disa ekzemplarë të shtypit ilegal që botohej në Perëndim dhe që përmes tij shpërndaheshin edhe në Sh. "L…", "B…", "L… i l…", e të tjerë libra e gazeta ilegale nuk ishin vërejtur prej policisë, sepse ajo kishte hulumtuar nëpër vitrinat, skutat e strehëve të shtëpisë, mos isha fshehur diku.

- Mos bëre një shkëputje nga xhaxhai kur nise të rrëfesh autobiografinë tënde? – e pyeta duke dyshuar mos ishte humbur, meqë e zgjati tepër për veten, ndonëse u pendova që e bëra këtë nga droja mos po ma

zë për të madhe bashkëbiseduesi im që mund edhe të hesht.

- Kurrsesi, - u përgjigj shpejt dhe me bindje, duke më shikuar thellë në sy, në e ndiqja me kujdes.

- I solla këto të dhëna në kujtesë që të vie përsëri te xhaxhai. Ai i dinte të gjitha peripecitë e mia me policinë, duke e përsëritur shpesh se ata nuk kanë besë. Një ditë xhaxhai, si më i vjetri që ishte, kishte tubuar burrat e gratë e familjes së tij të madhe dhe u kishte thënë për mua: "Këtë djalë e ka marrë në sy të keq pushteti. Nuk do ta lëmë vetëm, se mund të na qesh bota, duke thënë se ai është jetim dhe nuk ka kush të kujdeset për të. Dëgjoni, ju gra e nuse! Të gjitha do t'i shisni stolitë e arit dhe me ato para do ta nxjerrim nga burgu, nëse e do puna! Ai nuk ballafaqohet me këto halle për veten, por për popullin. I ka hyrë kësaj pune dhe Zoti e di ku do t'i dale fundi", i kishte porositur xhaxhai dhe të gjithë e kishin parë duke i pikur lot syve të rrudhosur nga pleqëria.

- Po flet për kohën…? - e pyeta disi i penduar.

- Ishte kohë e studimeve të mia, kur këto fjalë i kishte thënë xhaxhai, pra, babuçi, si e quanim në fëmijëri burrin e Nënës së Madhe. Jo vetëm që lexoja shumë, por edhe shkruaja poezi, kryesisht atdhetare. Nuk pajtohesha

me nëpërkëmbjen poshtëruese të popullit nga regjimi i YU-së, sidomos në RM.

Më shumë liri të fjalës kishin romët e turqit, që ishin shumë më pak se ne, ankohesha në lagje e fakultet. E dija se tepër po e fryenin balonin antishqiptar, ndaj një ditë do të pëlcasë ai duke shkaktuar zhurmë të madhe. Shumë keqtrajtime nisa t'i letrarizoj në poezi, të cilat i pati filluar në vitin 1978 dhe i përfundova kah viti 1990, kur nisën të fryjnë erëra të lehta për mendimin e lirë, sado e pjalmosur më dukej kjo demokraci. Këtë tufë poezish e pagëzova "Shtëpia" dhe e botova në librin "K… q…", në të cilin kisha shkruar se viti 2000 do të jetë nyje për fatin tim, me nëntekst të tyre.

Këtë e kishin vërejtur shumë lexues të librit dhe kishin pyetur: "Çdo të ndodhë në këtë vit?" Gazetari i "KP"-së në një intervistë mua qe kurioz të dijë se si ia kam qëlluar para më shumë se njëzet vjetësh, kur kam shkruar se viti 2000 do të jetë plot pikëpyetje për shtëpinë time, pra, kombin e atdheun.

Diçka profetike, sepse në vitin 1999 K. u çlirua nga pushtuesit, ndërsa në vitin 2001 edhe në M. u dridh historia nga lufta. Në mes të këtyre dy luftërave kisha vendosur fatin e kombit këndej kufirit. Poezinë "Shtëpia" edhe sot e lexoj në kompjuter, si e dashur që më është, ndonëse më e moçme se kompjuteri i vjetër që sapo e kam blerë. Sidoqoftë, është vegël e dashur për

mua, ndaj kohën më të madhe të ditënatës e kalon pranë tij.

- Ç'u bë pastaj me xhaxhain? – e pyeta këtë herë sikur doja t'i jepja vërejtje për shkëputjen e madhe nga rrëfimi për të.. - Është ende gjallë xhaxhai yt e Nënëmadhja, "vegla" e tij?

- Jo, - u përgjigj shkurt me kokë të ulur, si të shpjegonte fajin pse kishte bërë shkëputje nga rrëfimi për xhaxhain, vërejtje të bashkëbiseduesit që e kuptoi fare mirë.

- Atëherë...?

- Ëhë, edhe diçka m'u kujtua nga xhaxhai, - sikur erdhi në vete shkrimtari . - Më kujtohet kur qe shpërngulur nga Sh. në H.E. Gjatë një viti ndreqte shtëpi dhe duhej të martonte djalin e vogël. Shpenzime e lodhje të mëdha kishte përjetuar xhaxhai, sa një ditë kishte psherëtirë thellë duke thënë: "Bëri kush bëri shtëpi dhe martoi kush martoi djalë, sot e tutje është vështirë të bëhen këto", sepse kishte nisur një varfëri e ngutshme në popull. Këtë e kishte thënë nga dëshpërimi, sepse edhe më vonë kishin bërë shtëpi dhe ishin martuar njerëzit.

- …?

- Atë që më pyete se a është gjallë xhaxhai dhe "vegla" e tij, - sikur u kujtua në pyetjen e pakmëparshme, - vdiq në vitin 1993.

Që është më e dhimbshme për mua, nuk kam mundur të marrë pjesë në varrim, se atëbotë e kisha të ndaluar të hyja në K. Bile pesë vjet nuk kam qenë. Isha ndër themeluesit e një organizate politike-ushtarake në K. me synime të shtrirjes së veprimtarisë së saj edhe në M. Këtë e kuptoi regjimi, e zbuloi organizatën, disa i burgosi, të tjerët u arratisën në Perëndim.

Ndër këta të fundit isha edhe unë. Në vitet kur e kisha të ndaluar të hyja në Kosovë, vdiq xhaxhai. Dy vjet pas vdekjes së tij pata shkuar në Kosovë. Xhaxhai nuk ishte gjallë, por "vegla" e tij, Nëna e Madhe po. E shikoja atë dhe më përhirej xhaxhai, shmallesha me kujtimet e mia falënderuese për të.

(Dimër i vitit 2006-2007)

MIKU SHKRIMTAR KISHTE PARAPARË:

DO TË BËHEN NDRYSHIME TË MËDHA

E shtunë, kah ora 22.00, kur fëmijët kishte kohë që kishin rënë të flenë. Në dhomën e ditës rrinë bashkëshortët, Flamurja e Flakërimi. Në televizor nuk kishte emision interesant, ndërsa radios ia kishin ulur zërin, ku bënte një muzikë e lehtë, si e porositur nga bashkëshortët. Sa për ta dëgjuar vetëm ata.

Flakërimi tha se sonte ishte i disponuar të bisedojë.

Flamurja këtë e dinte, si çdo të shtunë që ishte i disponuar burri i saj për shumëçka, se të nesërmeve nuk shkonte në punë dhe kishte kohë të pushonte më gjatë. I tha gruas se diçka nga e rëndomta e të shtunave do të heqin sonte, ngase do të bisedonin gjatë, mbase deri në mëngjes.

Bile i tha gruas ta shkyçte banjën, se nuk e kishte hallin aty sonte.

Edhe ajo ishte e dhënë pas bisedës sonte, shkoi dhe e shkyçi banjën dhe i vuri dy kafe.

Kur i tregoi për këto, Flamuri e përkrahu se për të dyja kishte bërë mirë.

- Sikur edhe këta e dinë se sonte jemi të frymëzuar të bisedojmë, - tha duke e ndërprerë TV-në dhe lënë dirigjuesin mënjanë.

Flamurja i shkon pranë.

- Do të më tregosh me rëndësi sonte? – e pyeti burrin si të ishte lehtësuar nga ndonjë punë.

- Po, - iu përgjigj shkurt burri.

- Ndoshta nuk do të jetë me rëndësi të posaçme si kur vendosëm të kursejmë e gjithë familja.

- Është me rëndësi edhe më të madhe.

Flamuri e ndezi një cigare dhe u interesua për marrëveshjen familjare për kursim. Gruaja e siguroi se mirë po shkonin punët. Sidomos te Fatoni kishte përmirësime të dukshme, i cili ushqimin e konsumonte më me rregull, fle më shumë se më parë dhe nuk është nervoz.

Flakërimi e hapi dritaren, sikur donte të kursente edhe tymin e duhanit, të cilin pas marrëveshjes familjare e pinte më rrallë.

- Sot e pashë shkrimtarin, mikun tonë të rinisë, - nisi të rrëfejë Flakërimi.

- Si ishte? Ç'e kishte rastisur këndej? Pse nuk ktheu në shtëpi? – u interesua Flamurja për shokun e rinisë.

- Mirë ishte. Si i ftuar, kishte ardhur në një promovim libri të një poeti të qytetit tonë. Nuk kishte kohë, nxitonte për një mbrëmje kulturore në qytetin fqinj.

- Të rrëfeu gjë?

- Kishte qenë në Amerikë, në takimin e asociatës botërore të shkrimtarëve. Më tha se muajve e viteve të ardhshëm do të bëhen ndryshime të mëdha në botë.

- Edhe te ne? – ishte kureshtare të dinte Flamurja.

- Gjithsesi, - rrëfeu burri, në fytyrën e të cilit gruaja lexoi njëmendësi. – Se diçka do të ndodhë edhe te ne, dyshimin ma pati treguar qysh në bisedën kur e bëra disa ditë para Vitit të Ri.

- Pas kthimit nga Amerika i ishte rrënjosur bindja se diçka do të ndodhë?

- Bile shumë. Më tha se do të trazohen dete, toka e qielli, do të nxirren njerëz nga puna, do të rrihen e vriten njerëzit nga ushtria e policia pa pikë të fajit.

- Si kam lexuar edhe në libra, kësaj i thonë gati luftë, or burrë.

- Diçka më e madhe se lufta do të jetë, sa edhe kufijtë shtetërorë e kombëtarë do të ndryshohen, është e mundshme.

- Ndoshta te ne nuk do të ngjajnë këto të këqija, - sikur u vetëngushëllua Flamurja.

- Te ne do të jetë edhe më keq.

Flamurja e shfaqi hidhërimin e saj pse ai qenka i disponuar të bisedojë për gjëra të tilla, të besojë në mendimet e një shkrimtari sharlatan që i paska rrëfyer mikut të tyre shkrimtar. Flakërimi e luti të mos gjykojë asisoj për shkrimtarët dhe e luti të besojë se po pati njerëz profetikë në këtë botë, më së lehti mund të jenë shkrimtarët e artistët, të cilët shpejt nuhatin ndryshimet që mund të vijnë.

Flamures gati iu bë e mërzitshme biseda.

Sikur kishte harruar të ecte.

U ngrit t'i shohë fëmijët si flenë.

- Do të kursehen fëmijët nga këto absurde? – pyeti gruaja sapo u kthye.

- Do të jetë kohë e absurdeve. As foshnjat në djep nuk do të falen. Shkrimtarët i nuhasin planet që disa drejtues të botës i planifikojnë gjysmë shekulli më parë, ndoshta edhe më shumë.

Flamurja kishte bindje se shkrimtari amerikan që i ka folur mikut të tyre shkrimtar i ngjante rrenës së besueshme ose së vërtetës së pabesueshme, të cilat nuk mund t'i dallonte ajo.

Mendimin e gruas ai e kuptoi si ironi të bisedës. Këtë e kuptoi Flamurja dhe, për të pajtuar burrin, ia hodhi krahun mbi supe.

- Mos u prek, burrë. The se je i disponuar për bisedë. Rregull themelor i bisedës është sinqeriteti.

- Ke të drejtë, Flamure.

- Më intereson të di si do ta pësojmë ne. Vështirë do ta kemi. Jemi popull i vogël dhe i varfër kundruall fqinjve. Denbabaden na kanë shikuar vëngërr.

- Edhe për këtë më foli. Atë që e nënkuptova, fati i secilit është barometer i gjeturisë dhe përgaditjeve. Do t'i ngjajë lojës së futbollit. Duhet hyrë në ndeshje i përgaditur mirë, të mos e nënçmosh kundërshtarin. Çdo

gabim sado i vogël të jetë nga pakujdesia, mund të shkaktojë disfatën. Ai tha se do të ndryshojnë shumëçka. Kemi shumë miq, më shumë se kurrë, ngase jemi më të mençur se kurrë më parë.

Në paradhomë dëgjohet e ecur. Hapet dera dhe në dhomë hyn Fitorja.

- Ende nuk keni fjetur, - i pyeti fëmija prindërit duke i fërkuar sytë.

- Jo, bijë e babait, sot jemi zgjuar më herët se ditëve të tjera, - i foli Flakërimi duke e marrë në prehër të bijën.

- Mos keni parë ëndërr trishtuese?

- Kemi biseduar, kemi bërë plane.

- A jam e përfshirë edhe unë në ato plane, baba?!

- Je e përfshirë, bijë e babait.

- Vetëm unë?

- Edhe Festimi, Fatbardha, Fatoni.

- Mirë baba, mirë. Mirë nënë, mirë! - pëshpëriti vogëlushja duke i fërkuar sytë.

U ngrit dhe eci kah dhoma e fjetjes. Nëna e ndoqi pas.

- Paska qenë në jermi.

Flamuri ngritet në këmbë për të shpirë trupin.

- Thuaju fëmijëve se nesër kemi mbledhje familjare, - e porositi gruan. – Është koha të bëjmë një sy gjumë.

- Do të ju thuash gjë me rendësi për ta, burrë?

- Edhe për ne.

LIBRI I MBARUAR PAS VETËVRASJES

Osamu Dazai: "Jo më njeri", ShB "Shkupi",

Shkup" 2023, faqe 150

Emri i vërtetë i autorit japonez të romanit "Jo më njeri", që te disa botues njihet edhe me titullin "I përjashtuari", është Shuxhi Cushima, lindur më 1909 dhe vetëvrarë më 1948. Qysh si fëmijë, vërehet në këtë libër, ishte tejet i trazuar në rrethin shoqëror e jetësor, nga një familje e pasur, me edukatë e tradita pozitive. Në rini, sidomos atë studentore, shquhej për organizimin e qarqeve letrare, duke e drejtuar revistën "Rrethi letrar".

Sipas përkthyesit të Osamu Dazait, Donald Keene, ky libër në origjinal është në titullin "Ningen Shikaku", që i përshtatet titullit "I përjashtuar si qenie njerëzore" dhe që u thjeshtësua me "I përjashtuari". Si shtyllë narrative e kësaj proze, si kuptohet në kaptinën "Prologu", janë tri fotografitë e shikuara në njeriun, në të vërtetë bën zbërthimin e kokëve të tyre, mbase që kurrë

nuk i kishte parë, pos si të klonuara imagjinativisht. Njëra kokë është e një fëmije, e dyta e një studenti dhe e treta sj e një njeriu që i ngjitet koka e kalit. Rrëfimi nga arti fotografik kalon në atë letrar, përmes një shfletimi të tri fletoreve dhe pjesëve të tyre.

Autori krijon pamje të jetës sociale në familje fshatare, pjesë e të cilave ishte edhe kryepersonazhi Jozo, që më vonë do të vetëpërjashtohet nga rrethi familjar deri pak para vetëvrasjes. Intelekti i tij i zgjuar vërehet nga fëmijëria, që "në kërkim që të jenë ata, ashtu siç bëja se ka ndryshim, do të pështpëritja se isha i uritur dhe të fusja nga dymbëdhjetë karamele në gojën time...", lojë fëminore plot çapkënllëqe të ambientit fshatar.

Përshkruan kulturën e të ngrënit familjar, ku ky, si më i vogli, ishte në fund të rreshtit. Imagjinata e tij qysh atëbotë rropos të dijë përse njerëzit duhet të hanë tre vakte përditë? Por që shpesh kërshëritë mbeten pyetje retorike ose me përgjigje të nënkuptueshme. Fjala edhe me përgjigje antonimike, si kur i thënkan se ishte mirë dhe po i dukej sikur vuante në skëterrë. Me këtë do ta njohë veten dhe tjetrin te tjetri. Ngjashëm edhe kur i kthehet shikimit të fotografisë familjare, ku te të gjithë vërente fytyra të hareshme, kurse te vetja buzëqeshjen e shtrembëruar. Kjo është fytyra e Jozos. Personaliteti i Jozos qysh si fëmijë ishte i veçantë, çamarrok me dije notash të shkëlqyeshme, por jo edhe për sjellje. Jozo me kohë bëhet i joshur për gratë, të cilat te ky e kishin gjetur

burrin që e strukte dhe nuk e fshehte dashurinë. Si i ngujuar në vetminë e tij, sikur krijon klounin. Përreth ka personazhe tjera, si Petashuqi, Horiki, Joshiko e ndonjë tjetër. Ka shkathtësinë e tipizimit të tjetrit, specifikimit karakterizues të tjetrit, brengës për tjetrin dhe sikur është përgjegjës për të, edhe kur motiv e temë është vetja e tij, si ishte rrethana e pirjes së rakisë panevojshëm. E vërejmë në dialogjet kur premton ta braktisë rakinë e nuk e bën, pastaj edhe drogën, bile i shet pikturat për sigurimin parave.

Kishte logjikë të veçantë Jozo, i cili mund të besonte në ferr, por jo edhe në ekzistimin e parajsës. Gjatë dialogut të Jozos me Horikin, ideja se antonimi i krimit është vesi, formësohet në bindjen se antonimi i vesit është virtyti. Antonimi bëhet filozofik edhe kur për Zotin pandeh se ka antonim djallin, për shpëtimin humbja dhe për dashurinë antonim është urrejtja. Edhe kur përsiat me delikatesë, Jozo shpesh ik nga vetja, bëhet kloun, jovetja. Edhe kur bën pyetjen retorike se: është besimi i papërlyer një mëkat? Ia kënda t'i riciklojë kujtimet nga vëllimi jetësor.

Jozo është përjetues i çrregullimeve shoqërore i fill pasluftës, shthurrja morale e mendore e tij kishte arritur kufijtë e jonatyrshmes, sa nga dëshira të marrë drogën, i kopjon pikturat pornografike të tij, sidomos pas rritjes së borxhit në barnatore. Shthurjet të gjitha sikur e çojnë në vetëvrasje, përpjekjen e fundit të të cilit e vërejnë

Petashuqi, Horiki e Joshiko, të cilët me makinë e dërgojnë në një spital malor për tre muaj, nga ku pastaj e marrin Petashuqj e vëllai i Jozos, e tërheqin nga Tokio dhe i krijojnë kushte në fshat. Vuajtjet jetësore janë mëdha, sa njëzeteshtatëvjeçari duket dyzetvjeçar. Brumi letrar i romanit është ngjeshur në ngjarjet e viteve 1935-1938. Ndër arsyet e klithmës letrare të këtij romani duket edhe shtypja e rritur nga klika ushtarake japoneze, për më tepër një shkrimtari të ri me bindje komuniste. Galeria e personazheve është bashkëkrijuese me heroin kryesor të romanit "Jo më njeri", duke i shpëtuar tri fletoret e tri fotografitë që mund të bëjnë material të mirë për një roman. Nga pikëpamja letrare shikuar, Jozo i romanit "Jo më njeri", i njohur edhe me titullin "I përjashtuar", është një i ri që lufton me jetën e pasluftës me pasiguri të brishtë për më keq me bindje e aderim komunist në Japoni. Me jetë rebele, qysh më 1933 nis të nënshkruhet me pseudonim, si bën me prozën "Treni". Shpesh e hasim të shtjellojë përmes personazheve e ngjarjeve ndjenjën e fajit si pengesë jetësore. Stili autobiografik shëmbëllen në prozat e F. Dostojevskit e M. Prustit, cilësojnë kritikët letrarë për veprat e tij. Kuptohet që është i veçantë nga ta me simbolikën e veçantinë se Osamu Dazai sikur librin gjysmëbiografik të tij e mbaroi pas vetëvrasjes bashkë me gruan që jetoi vitin e fundit të jetës me shkrimtarin Osamu Dazai.

BËRTHAMA E FATIT TË NJERIUT

QË IDENTIFIKOHET ME POPULLIN LETON

(Fragment nga vështrimi për librin sipas aspektit të analogjisë së Letonisë me shqiptarët në Kosovë e Jugosllavi, lexuar gjatë promovimit të librit më 18.03.2011 në Shkup)

Sandra Kalniete: *"Këpucë balerine mbi dëborën siberiane"*, roman, ShB "Shkupi", Shkup 2010

Sandra Kalniete nga Letonia na e sjell një libër tejet interesant, që nis nga individi dhe bërthama e organizimit të tij në familje e deri në fatin e një populli. Në librin e saj "Këpucë balerine mbi dëborën siberiane" autorja sjell fatin e lindjes së njeriut pa atdhe, fat i nëpërkëmbur nga prepotenca e të fortit të padrejtë, etatist e pushtues i pamerituar i shpirtrave të njerëzve të një populli dhe vendi aparteid. Ndërsa lexoja librin e Sandres, nëpër parafytyrime me silleshin fatet analoge të

populllit tim, të familjeve shqiptare, të përndjekura dhe të zhvendosura jo një herë në histori.

Nëna e saj kishte tri dëshira, sipas saj, të kthehej në Letoni nga internimi në Siberi, të shikonte edhe një herë vëllezërit e saj dhe të kishte një strehë (banesë) për familjen e saj. Fatbardhësisht, të tria dëshirat iu realizuan. Por, gjatë tërë jetës nëna e saj zgjohet e trembur nga gjumi me përjetimet e tmerrshme në jetë. Nga personaliteti i nënës së saj mësojmë se në jetë njeriu gjen bukuri në shëmti, të cilën e kuptojmë kur në varfërinë e thellë gruaja fisnike, pra nëna e saj, një copë bukë e ndan në gjysmë dhe ia lë burrit të saj kur të kthehet në shtëpi nga puna.

Me gjithë varfërinë, kishin një filozofi të thellë, sa nuk donin të sillnin në jetë skllevër të rinj nën regjimin robërues. Në këtë kontekst më përhiren bashkëshortët shqiptarë, që edhe veten e lenin të uritur, vetëm e vetëm të ngopej bashkëshorti, fëmija e farefisi në gjendje lufte ose varfërie, si ndodhi jo rralle edhe në luftën e fundit të Kosovës, përjetues të së cilës jemi shumë të pranishëm edhe këtu.

Dhelpëria pushtuese e Bashkimit Sovjetik na kujton atë të Serbisë ndaj Kosovës dhe trojeve shqiptare në ish-Jugosllavinë. Qeveritarët letonë me pretekstin te kursehej popullata, e dorëzuan pushtetin në duart e

rusëve pa rezistencë, bile edhe me muzikë, kur radioja transmetonte nga festivali në Latgale.

Edhe dhelpëria e Serbisë se do të lejohej vetëpërcaktimi i Kosovës pas mbarimit të luftës, e pastaj dinakërisht të mohohej, sepse kjo nuk mund të bëhet ngase zemërohen serbët e Jugosllavisë, janë arsyetime bajate, ashtu si në fillim Armata e Kuqe shpjegonte ta ketë Lituaninë si vend fortifikimi kundër nazistëve, e pastaj u ngujuan përfundimisht në të dhe e bënë më 5 qershor 1940. Letonia bëhet republika e katërmbëdhjetë e BRSS.

Premtimet e presidentit leton Ulmanski se unë do të rri në vendin tim, ju në të juajin, u zbehën dhe përfunduan në firmosjen e kapitullimit. Në shenjë proteste ndaj faktit që lejuan ushtria ruse të hyjë në Letoni, gjenerali Bolstein vret veten, që nënkuptimisht le të kuptojë padëshirën e popullit e ushtrisë së Letonisë të pranojë marshimin e ushtrisë së huaj nëpër vendet e tyre.

Ngjashëm bënë nënshkrimin kapitullues të partizanëve jugosllavë të Kosovës që të hyjnë nën sundimin e Serbisë, me të cilin vullnet nuk pajtohet Shaban Polluzha e nacionalistë të tjerë shqiptarë. Edhe zgjedhjet e para, kur nuk iu lejua Frontit Demokratik antisovjetik të jetë pjesëmarrës, ishin tragjikomedi se si vullnetarisht po integrohej në jetën parlamentare sovjetike edhe Letonia, ashtu si do të detyrohej që edhe

Kosova të votonte pas luftës së dytë botërore për parlamentin serb e jugosllav. Ironia më e madhe fatkeqe për popullin leton ishte kur një delegacion leton kukull shkoi në Moskë gjoja të shprehë dëshirën e zjarrtë të popullit leton të futet nën Bashkimin Sovjetik.

"Peshqesh" i pushtetit sovjetik ishte rreth 35.000 njerëz të shfarosur, si shtazë të deportuar në veri të saj; gra, pleq e fëmijë, thënë në përqindje, çdo i 18 i saj në një mijë banorë. Nga ky numër, vetëm brenda një nate janë internuar kafshërisht mbi 15.000 veta. Shënimet mësojnë se ata janë vendosur nëpër vagonë, bile edhe nevojat fiziologjike i kryenin para syve të njëri-tjetrit, përkundër faktit se në vagona kishte gjini të ndryshme njerëzish. Pikërisht para internimit, Viktori ia sjell një palë këpucë motrës Ligitë dhe këto do ti shërbejnë në dimrin e parë të acartë në Siberi. Pra, këtu është historia e titullit të librit. Ngjashëm vepruan edhe partizanët jugosllavë të dominuar nga serbët, kur nisën vrasjet masive në monopolin e Tetovës, Bllacë të Shkupit, Tivar e Trogir me vrasjen e mijëra shqiptarëve dhe dërgimin e dhunshëm në luftërat e Sremit dhe në tërë Jugosllavinë.

Ndaj, traktati ruso-leton i vitit 1920, kur Rusia pa rezervë e njihte pavarësinë dhe sovranitetin e Letonisë, lëre që u harrua, por edhe u gjenocidua skajshmërisht. Ngjashëm bëri edhe Serbia nën emrin e Jugosllavisë ndaj Kosovës e shqiptarëve, lere qe nuk e lejoi të vetëpërcaktohej, por edhe bëri projekte shfarosëse ndaj

tyre, duke i shpërngulur masivisht në Turqi, duke i vrarë dhe dëbuar nga Kosova, si ndodhi në vitin 1989. Pushteti sovjetik sajonte edhe absurde te llojit të vet, sa kishte të drejtë së pari ta vriste, e pas gjashtë muaj të lëshonte fletë arrestin ndaj të ndjerit, si ndodhi me gjyshin Janis Dreifeld. Dhe, gjyshi vdiq pa e ditur fatin e të afërmeve të tij, ashtu si do të vdisnin shumë shqiptarë të Kosovës anekënd saj pa ditur se ku ishin njerëzit e tyre. Toka e Letonisë u bë arenë e shumë ushtrive. Më 22 qershor 1941 Gjermania sulmoi BRSS dhe pak kohë më vonë edhe u duk në trojet e Letonisë. Ndihej një frymë më liberale gjermane ndaj Letonisë se sa në kohën e BRSS, sa edhe nisi ritransmetimi i Radios dhe të dëgjohej himni "Bekoje o Zot Letoninë".

Frymimi më i lirë nën protektoratin gjerman në krahasim me shtypjen sovjetike, e bëri që populli më ngrohtë ta presë pushtuesin e ri. Ky "entuziazëm" pas Luftës së Dytë Botërore, pra pas largimit të Gjermanisë nga Letonia dhe ripushtimi sovjetik i saj, bëri që disi BRSS t' u hakmerret letonëve. Ngjashëm ishte edhe me Kosovën nën pushtimin gjermano-italian, kur u hapën për herë të parë edhe shkollat shqipe të ndihmuara nga ministri i atëbotshëm, Ernest Koliqi. Por, pas Luftës II Botërore, edhe Serbia, ngjashëm si BRSS me Letoninë, i proklamonte Kosovën e shqiptarët si pro nazistë dhe ndërmerrte masa për shfarosjen e elementeve fashiste në mesin e shqiptarëve, si pati bërë edhe pushteti sovjetik

ndaj letonëve, në mesin e të cilëve ishte edhe gjyshi i autores, Akeksandrës, të cilin e morën nga shtëpia dhe e ekzekutuan.

Autorja Sandra Kalniete shumë mirë thotë në libër se "Nëpër gazeta portreti i Fyhrerit zëvendësoi atë t vëllait të vogël, Stalin. Në vend të këngëve të lavdishme të heronjve të Armatës së Kuqe (pra ruse), tani jehonin këngët e çlirimtarëve trima të Vermahtit (nazistë). Gjermanishtja nisi të përdorej në njoftimet ekonomike, duke zëvendësuar kurse të rusishtes.

Rreth 25.000 funksionarë të Rajhut të Tretë arritën në Letoni për të administruar territoret e reja, midis tyre edhe shumë gjermanë baltikë të rikthyer me familjet e tyre, të gatshëm për të shijuar hakmarrjet e tyre". Me këtë autorja sikur do të përshkruajë fatin e popullit leton, se secili pushtues vie me të këqijat e veta, por populli kërkon të mira të mundshme edhe ndër të këqija, ndaj edhe mllefi është më i madh kur has në më shumë të këqija. Por, qoftë nën nazistët ose sovjetikët, fati i letonëve ishte ikja në lindje, pra përndjekja, kolonializmi ose pushtimi klasik. Ai kurrë nuk pajtohej me të huajin, sa edhe bulevardin e Lirisë kurrë nuk e quajti Hitler, si ngulnin këmbë nazistët.

Kaptinë në vete ishte edhe shfarosja e hebrenjve në Letoni. Vetëm në nëntor e dhjetor të vitit 1941 në pyllin Rambula u masakruan rreth 24.000 hebrenj nga

Letonia dhe 1.000 nga Gjermania. Ishte ngjarje e llahtarshme, në të cilën tragjedi masive nuk kishte gisht e faj populli leton. Por, pas mbarimit të LDB (lexo: Luftës II Botërore), pushteti sovjetik synonte të propagandonte se në Letoni janë vrarë me mijëra hebrenj, gjoja edhe me fajin e letonëve. Por, përgënjeshtrim i kësaj ishte fakti që shteti izraelit me dhjetëra e qindra letonë i shpalli njerëz të drejtë , kurse u pranua e vërteta se rreth 1.500 letonë janë përpjekur për shpëtimin e hebrenjve. Bile gjyshja e autores, Matilda e kishte ndarë bukën me gratë hebreje, kurse propaganda antiletone shpërndante "të vërtetën" se letonët ishin antisemitë në palcë.

Propagandë me hipokrizi ishte edhe në Jugosllavi, konkretisht në Maqedoni, kur shiheshin shkrimet se shqiptarët ndihmuan në shfarosjen e hebrenjve. Kurse, e vërteta ishte ndryshe. Vetëm në vitin 1943 në monopolin e Shkupit u grumbulluan me mijëra hebrenj dhe i deportuan me trena nën kushte të mjerueshme për në Serbi, e nga andej shfaroseshin rrugës dhe dërgoheshin në Kampin e shfarosjes në Treblinkë e gjetiu. Nga rreth 8.000 hebrenj, sa kishte në Maqedoni, mbi 7.000 u shfarosën, ndaj sot ne Maqedoni ka diçka mbi 100 hebrenj. E vërtetë e pakontestueshme është se shqiptarët e Shkupit i shpëtuan nga vdekja e sigurt me dhjetëra e qindra hebrenj dhe për këtë disponojmë dëshmi të patundshme.

Njeriu i thjeshte, i varfër e punëdashës, si ishte babai i autores, Aleksandras Kalnietis, edhe kur për kafshatën e gojës punon në ndonjë kantier ushtarak, do të akuzohet e dënohet pr ndihmë armikut, si e akuzonte pushteti sovjetik në Letoni babain e autores. Fryma çlirimtare dhe antikonformizmi ndaj sovjetikëve pushtues te ai nuk pushoi kurrë, ndaj edhe iu bashkangjit Vëllezërve të Pyllit, një organizim antisovjetik. Aleksandrës nuk ndenji as edhe 13 ditë nga ardhja në shtëpi, e zunë ushtarët sovjetikë dhe e rrahën me biseda deri në mbytjen e fundit nga torturat.

Duke lexuar librin "Këpucë balerine mbi dëborën siberiane" të autores Sandra Kalniete vërtet lexuesi pak i informuar nuk mund të shkëputet nga fati gati binjak i letonë-shqiptarëve dhe Letoni-Kosovës. Libri, si objekt studimi në preokupimin tim, i ka rreth 12 faqe të shkruara, i shpërndarë në 5 kaptina, por u ndala në atë të analogjisë letonezo-kosovare.

Ashtu si sillej BRSS ruse ndaj Letonisë, sillej edhe RSFJ serbe ndaj Kosovës. Atje kishte një Parti Komuniste policore-ekzekutive, këtu kishte një Lidhje Komuniste; atje kishte Gulagun, këtu kishte Goli Otokun e Idrizovën, Atje kishte KGB e NKVD, këtu UDB-në. Atje vritej, burgosej e deportohej populli, ngjashëm edhe këtu.

Libri ka peshën e së vërtetës së zhveshur nga pluhuri i së pavërtetës, të prepotencës pushtetore

komuniste. Brenda faqeve të tij hedhin dritë fusnota, shënime e komente me metodologji verifikuese. Ndaj, botimi i librit “Këpucë balerine mbi dëborën siberiane” i Sandra Kalnietes është pasuri librore që frymëzon mendjen krahasimtare të lexuesit shqiptar.

Puna e madhe e shtëpisë botuese “Shkupi” nga qyteti homonim ka meritë të madhe. Duke e prerë si me thikë këtë qasje time ndaj këtij libri, tekstin tm po e përfundoj me uratën miqësore “Bekoje, o Zot, Letoninë!”, "Bekoji, o Zot, Kosovën e shqiptarët!" dhe shpërbleje autoren me të mirat që di e mundesh. Ju faleminderit për vëmendjen.

PROZA TURKE ME SHËNDET LETRAR

Sot kemi një ngjarje të madhe kulturore, kur para lexuesit shqiptar janë në duar vepra me rëndësi të letërsisë turke, autorë të të cilave janë shkrimtarët e dëshmuar. Shtëpia botuese "Shkupi", që mban emrin e kryeqytetit të Maqedonisë dhe të Vilajetit të Kosovës gjatë fundit të sundimit osman në nënqiellin tonë, këtë herë me botimin e kolonës letrare, hapi një dritare të depërtimit të kulturës turke edhe te ne.

Reshat Nuri Gyntekin në këtë kolonë botohet me tre librat e tij prozaikë, "Degët e thanës", "Njolla" dhe "Rënia e gjetheve". Letërsia e viteve tridhjeta të shekullit të kaluar, kur krijon ky shkrimtar, mëton të letrarizojë temat e personazhet sociale me syrin e shkrimtarit hulumtues dhe tipologjizues. Fati i vajzës së birësuar dhe preokupimi i gjyshes ballafaqon identitetet e brezave dhe kohëve. Poashtu, tipi i Ilfetit, djalit të një pashai, është personazh që drejtësinë e ka pasion jetësor. Jeta e tij është plot sakrifica, në këtë lundron dashuria dhe njollosja e personazhit. Në këtë prozë ka përplot enigma që ngacmojnë kërshërinë e

lexuesit të gjejë zgjidhje për shumë çështje. Kontroversat deri në dramatizimet të ambienteve familjare në shoqëri do të vërehen edhe në romanin e Gyntekinit "Rënia e gjetheve", botuar në vitin 1930. Proza interesante janë edhe librat "Qelia numër shtatëdhjetë e dy" edhe "Lufta për bukë" i Orhan Kemal, mikut të burgut të Nazim Hikmet. Përpjekje për demitizim të së panjohurës dhe detabuizim të temave vërehen në romanin "Zbukurimi i karafilave" të Ajla Kutlu, sidomos për hapjen e letrarizuar të shpirtit femëror, e cila me vlerat e saja letrare që i posedon, nderohet me shumë shpërblime letrare.

Autor tjetër tejet kurioz është Zulfu Livaneli me romanin "Shkëlqimi verbërues në sytë e gjarprit". Ky shkrimtar, ndër më të përkthyerit e më të shpërblyerit nga rrethet letrare turke e botërore, që në Francë u dallua nga dymijë bibliotekat dhe u filmua letërsia e tij. Në këtë libër historiken e demistifikon, duke mos saktësuar data e emra, duke shfrytëzuar ngjarjet e figurat si përvojë historike e fatit të njeriut, jo vetëm nga historia osmane, por që mund të jetë edhe si përvojë jashtëturke. Identiteti historik, edhe i osmanlive në prozën e Zulfu Livanelit, prore sitet në vrimat e kullueshme të dëshmisë dhe të së vërtetës së penës letrare të Livanelit.

Kritika letrare gjykon se në veprat e tij Sabahutin Ali nxjerr në dukje fytyrat e padukshme të njerëzve. Në

librin “Madona me mantel gëzofi” parqaqet portretin e një pasionuesi të fortë. Me personalitetet që ka fshirë rendi, parashtron pyetje të vështira, të cilave shumë rëndë mund t’u jepet përgjigje në jetën dhe pamundshmërinë e dashurisë. Nga ky libër dhe pena letrare e Sabahutin Aliu mësojmë se disa pasione na bëhen udhërrëfyes gjatë gjithë jetës. Pa i analizuar mirë, shkojmë pas tyre dhe jemi të sigurt se asnjëherë nuk do të pendohemi.

Duke i lexuar librat e shkrimtarëve turq Reshat Nuri Guntekin, Orhan Kemal, Ajla Kutlu, Zulfu Livaneli, Sabahutin Ali e ndonjë tjetër që në saje të shtëpisë botuese “Shkupi” të Shkupit u ofrohet lexuesve shqiptarë të këtushëm, futemi në jo vetëm letërsinë e jetën turke të kohëve e temave të ndryshme, në stile e letrarizime mjeshtërore, por njohim edhe kultura jetese e botëkuptimesh. Shikuar nga aspekti i sociologjisë e kulturologjisë, industria letrare turke i ka munguar lexuesit ballkanik, sidomos atij shqiptar. Kjo që zhvillohet në dy kontinentet, sot nuk po rrezaton vetëm ne Azi e Evropë, por në dhjetëra e qindra civilizime të botës. Pse, pra të mos konsumojmë edhe ne shqiptarët artikujt botimorë të kësaj industrie letrare.

Ju dëshiroj lexim të këndshëm të librave të autorëve turq euroaziatikë.

PËRMBAJTJA

Udhëkryqi 5
Hëna 24 12
Hani i tre djajve 17
Kthimi mbrapa dhe psikiatri psikopat 23
Intervista me personazhet 27
Unë jam uni me hijen time 33
Gjeografia e poezia
Qytetet e vendet shqiptare të Maqedonisë
në poezinë e Josif Bagerit 34
Eh, shkrimtar i harruar,
Ramadan Zejneli (1952-1993) 40
Ti shkruaj për librin tim,
unë shkruaj për tëndin 43
Zhduken gjurmët
e shqiptarëve të krishterë në Shkup 46
Rëndësia shqiptare
e Kongresit të Manastirit 48
Gaspër Gjini
dhe Ipeshkvia Shkup - Prizren 54
Porosia edukative për bashkimin kombëtar
e këngëve të ciklit të murosjes 56
Kënga e Hasan Agës 61
Aga Imeri 62
Shqiptarët nuk janë komb dordolec
me identitet evro-aziatik 63
Mësuesi i vyeshëm
është nxënës i tërëjetshëm 67
Zemërimi i delfinit në djaloshin 74
Fragmente nga romani në dorëshkrim (1) 78
Fragmente nga romani në dorëshkrim (2) 83

(Skicë për një prozë më të gjatë)
Kujtimi për xhaxhain 88
Unë jam uni me hijen time 94
Miku shkrimtar kishte paraparë:
Do të bëhen ndryshime të mëdha 102
Shtegtime letrare
Libri i mbaruar pas vetëvrasjes 109
Bërthama e fatit të njeriut
që identifikohet me popullin leton 113
Proza turke me shëndet letrar 122

Fadil Curri
“HANI I TRE DJAJVE”
(Prozë letrare)

Lektura, korrektura,realizimi kompjuterik dhe kopertina
ShB "Shkupi"

Tirazhi: 500 copë

Shtypi: Shtypshkronja
"FOKUS Print"-Shkup

Botimin e këtij libri e ndihmoi
Ministria e Kulturës
e Republikës së Maqedonisë së Veriut

CIP-Katoligizimi në Bibliotekën
“Sh. Klimenti i Ohrit” – Shkup
CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека
"Св. Климент Охридски", Скопје

821.18(497.115)-32

CURRI, Fadil
Hani i tre djajve : (prozë letrare)
/ Fadil Curri. - Shkup : Shkupi, 2024.
– 143 faq.стр. ; 21 cm. см
ISBN 978-608-224-190-6
COBISS.MK-ID 63769093
127